# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7639 E diel 2 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)









Opinioni i Ditës

Nga BLERIM LATIFI

## Roli i Enver Hoxhës për Kosovën dhe çështjen kombëtare



Edhe pse kanë kaluar 27 vite nga rënia e regjimit komunist shqiptar, vazhdon që të ketë shumë shqiptarë të Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare ...

Vijon në faqet 21-22

Dje në "Zëri i Amerikës"

Nga HASHIM THAÇI

## Koha për marrëveshje historike me Serbinë



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha të shtunën se procesi i kërkimit të marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve me ...

Vijon në faqen 22



"Teatri, kërkuam ekspertizën e KE"

## Vlahutin: Jo të gjithë e donin reformën, politika të gjejë zgjidhje

### Ambasadorja e BE largohet nga Shqipëria: Ky vend mund të shkëlqejë me shumë shpejtësi

Ambasadorja në largim e BE-së në vendin tonë Romana Vlahutin, deklaron se është kërkuar ekspertizë nga Komisioni Europian për ligjin e Teatrit Kombëtar, ndërsa pritet një përgjigje prej tyre. Romana Vlahutit deklaroi në një intervistë për Top Channel në përfundim të mandatit të saj si ambasadore e BE-së në Tiranë, se misioni ...

Në faqet 2-3

SHKODER/ QELLOHET 30-VJEÇARI ARJAN FERRACAKU, BABA I DY FEMIJEVE

# BRESHERI PLUMBASH, VRITET BIZNESMENI

I riu qëllohet me kallashnikov, gjendet pranë makinës së djegur. Në tre muajt e fundit, 6 të vrarë dhe 2 të zhdukur. Voltana Ademi: Krimi bën ligjin






*(Në foto)* Viktima, Arjan Ferracaku. Policia në vendin e vrasjes së 30-vjeçarit

Në faqen 7

RRUGET

### Rama: Bypasi i Fierit, besojmë do jetë funksional brenda vitit tjetër

Në faqen 4

LISTA E PLOTE

### Patentat, emrat e shoferëve në rrethe që kanë gati kartonin

Në faqet 8-10

UDHEZIMI

### Tatimet, apel bizneseve: Ja si të paguani detyrimet me këste

Në faqen 6

KULTURE

### Sa lexojmë? Debat mes drejtoreshës së ministrisë dhe botuesve

Në faqen 12

ZBARDHET FORMULA



### Shitblerja e shtëpive, ja sa do paguajnë pronarët

Në faqen 5

MILOSAO

Diktatori i bëri dhuratë kreut të sovjetëve rrobën e princit të Mirditës

## Kostumi i Preng Bibë Dodës iu fal Hrushovit

*Në brendësi: In memoriam, Teodor Keko. Demir Gjergji dhe Faslli Haliti*

Nga NDREK GJINI

Napoleoni i III (1808 – 1873) ka qenë kumbari i Preng Bib Dodës.

Këtë fakt e mësova veç disa muaj më parë. Një kolegu im, lektor i lëndës së Gjenealogjisë në Universitetin Kombëtar të Irlandës





në Galway, në pushimin mes seancave të një konference kushtuar Napoleonit të III më tha; - A ka në Shqipëri një muze kushtuar Bib Dodës? Nuk jam i sigurt, - i thashë – por nuk besoj të ketë. Atë mbrëmje, pas konferencës ...

Suplement

# REFORMAT INTEGRUESE
## INTERVISTA

Teatri, Vlahutin: Kemi kërkuar ekspertizë nga Komisioni Europian, do shprehen për ligjin

# Vlahutin thirrje politikës: Dialog, gjeni zgjidhjet për vendin tuaj

### *"Kritikat? Jo të gjithë e deshën reformën në drejtësi"*



Gjatë një seance parlamentare



Ish-ambasadorja e BE-së në Tiranë Romana Vlahutin

**EKSPERTIZA**
"Për momentin, shërbimet tona janë ende duke shqyrtuar disa detaje lidhur me këtë ligj. Kam folur me kolegët e mi në Bruksel dhe shpresoj që shumë shpejt shërbimet do të vijnë me përgjigje mjaft precize, pasi kishte disa çështje dhe ata donin të bënin disa pyetje shtesë",-tha zj.Vlahutin.

**THIRRJA**
"Ky vend mund të shkëlqejë me shumë shpejtësi. Mendoj do të ishte një gabim i tmerrshëm i partive politike e, do të thosha, i të gjithë spektrit politik, nëse nuk tregojnë më shumë vullnet të mirë për të folur me njëri-tjetrin e për të gjetur zgjedhjen më të mirë për vendin",-deklaroi z.Vlahutin.

Ambasadorja në largim e BE-së në vendin tonë Romana Vlahutin, deklaron se është kërkuar ekspertizë nga Komisioni Europian për ligjin e Teatrit Kombëtar, ndërsa pritet një përgjigje prej tyre. Romana Vlahutit deklaroi në një intervistë për Top Channel në përfundim të mandatit të saj si ambasadore e BE-së në Tiranë, se misioni i reformës në drejtësi u krye. Ajo flet për katër vitet e qëndrimit këtu, sulmet e opozitës, kanabisin, ndërsa shprehet se në Bruksel do të punojë sërish në lidhje me Shqipërinë.

**Zj. Ambasadore, ju jeni në fund të mandatit tuaj në Shqipëri. Reforma në drejtësi është ndoshta një nga çështjet më të rëndësishme që keni ndjekur gjatë këtij mandati. Ka shumë njerëz që mendojnë se ka qenë edhe një sfidë gati personale e juaja. A mendoni edhe ju kështu? A mund të thoni tani se ia arritët qëllimit, misioni u krye?**

Absolutisht. Po largohem me zemrën plot, sepse mendoj që kemi bërë një punë mjaft të rëndësishme për Shqipërinë. Reforma në drejtësi ishte nëna e të gjitha reformave, beteja kryesore mbi të gjitha betejat dhe vetëm fakti se shumë shpejt të gjitha institucionet kryesore të sistemit të ri do të mund të krijohen, pasi mendoj që lista e vetingut parësor thuajse është shteruar- mendoj kanë mbetur edhe pak raste për të përfunduar - më bën të largohem, siç e thashë, me zemrën plot dhe mjaft krenare për atë çka arritëm të bënim.

**E kishit imagjinuar ngërçin që është krijuar së fundmi me sistemin e drejtësisë në Shqipëri ku kemi dy prej gjykatave kryesore që janë praktikisht jashtë funksionimit, ndërkohë që për sa i përket reformës, vetëm organet e vetingut po funksionojnë aktualisht.**

Kjo reformë duhet të krijojë në një lloj mënyre një sistem nga zeroja dhe mendoj se do të ishte e pamundur të pritet që diçka e cila është shkatërruar për dekada të mund të rikrijohet brenda një viti. Po ta shohësh objektivisht atë çka është bërë, kjo ishte në thelb një reformë kushtetuese. Është ndryshuar një e treta e Kushtetutës shqiptare dhe me shumë vullnet politik që ishte i dyshimtë përgjatë procesit dhe shumë luftë për reformën. Kur vjen fjala për kohën, mendoj se reforma po ecën shumë mirë. Sapo lexova disa ditë më parë të gjithë emrat e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe jam absolutisht jo vetëm shpresëplotë, por, nëse ka vullnet, vullnet politik, të gjitha institucionet mund të jenë plotësisht funksionale deri në fund të vitit, përfshi të rinjtë, mjaft të rëndësishëm për shqiptarët dhe kjo është Prokuroria e Posaçme, SPAK-u, si dhe BKH-ja.

**Mund të marrim si shembull Këshillin e Lartë të Gjyqësorit ku duket se përsëriten apelet që gjyqtarët të bëhen pjesë e këtij institucioni. Pse mendoni se ka një lloj hezitimi për t'u bërë pjesë e drejtësisë së re?**

Ju thoni se ka hezitim, por ka kandidatë dhe shpallja është ende e hapur, ndaj nuk mund të gjykojmë përpara afatit. Sigurisht, para së gjithash, ky është një funksion i rëndësishëm, ndaj mendoj që njerëzit që e marrin përsipër duhet të kuptojnë çfarë po marrin përsipër, ç'lloj përgjegjësie do të duan të kenë. Po kështu, sigurisht që të gjithë ata që janë pjesë e gjyqësorit duhet të kalojnë sistemin e rivlerësimit. Është përherë sfidë të nisësh diçka nga fillimi, por është shumë e nevojshme, ndaj u jam, gjithashtu, mirënjohëse të gjithëve atyre që janë të gatshëm të marrin përsipër përmbushjen e këtyre funksioneve dhe të ndihmojnë realisht për krijimin e sistemit të mirëfilltë gjyqësor në Shqipëri dhe mendoj që ata mund të jenë vetëm krenarë për veten.

**Pavarësisht debateve politike të muajve të fundit, ka të paktën një temë, një tjetër reformë e rëndësishme, që është reforma zgjedhore, ku të paktën partitë duket se po dialogojnë. A mendoni se do të kemi një produkt në vjeshtë apo mendoni se ky acarimi i klimës politike që është paralajmëruar mund ta vendosë në rrezik këtë reformë?**

Do të jem shumë e ndershme me ju. Kam zhvilluar disa takime me dy bashkëkryetarët që e drejtojnë këtë komision dhe jemi habitur të gjithë shumë për mirë nga kolegjialiteti dhe mënyra sesi po punonin së bashku. Detyrat janë të qarta dhe kanë qenë të qarta prej shumë e shumë vitesh. Rekomandimet e ODIHR-it nuk janë rekomandime të reja, janë të vjetra. Mendoj që të gjithë politikanët e përgjegjshëm që duan vërtet që vendi të përparojë do të ulen në tryezë e do të gjejnë zgjidhjet që janë më të mira jo për veten e tyre, por për vendin. Ndaj, ajo çfarë kam parë, ajo çfarë kemi dëshmuar sa i takon angazhimit të përfaqësuesve të të dyja partive që janë në këtë komision dukej si një diskutim mjaft i shtruar dhe shpresoj që do të japë rezultate. Është shumë e nevojshme. Ka zgjedhje vendore verën e ardhshme dhe, më pas, zgjedhjet parlamentare pas dy vitesh dhe mendoj se është shumë e rëndësishme që, më në fund, disa nga rekomandimet kryesore të ODIHR-it dhe realiteti i zgjedhjeve siç i njeh vendi të ndryshojë.

**Mund të themi me siguri se partitë politike dhe ambasadorët jo gjithmonë kanë qenë në dashuri me njëri-tjetrin, por ndoshta ju jeni ambasadorja më e sulmuar, më e kritikuar, nga opozita kryesisht. A keni krijuar pas këtyre viteve një ide pse vinin këto sulme?**

Mendoj që hapëm dosjen më kritike, hapëm gjyqësorin dhe, ndershmërisht, ishte absolutisht e parashikueshme që grupet e interesit do t'i viheshin pas kësaj reforme, kështu që nuk është asgjë personale. Është një zhurmë logjike do të thosha, që u bë nga njerëz, të cilët nuk janë të lumtur nga reforma dhe donin t'i mbanin gjërat siç ishin. Për mua, personalisht, ishte në kuptimin e plotë vetëm zhurmë dhe ajo çfarë mendoj që është më e rëndësishme, apo e vetmja gjë e rëndësishme, janë rezultatet.

**Çështja e kanabisit ju përmendet shpesh. Përtej raporteve të Brukselit apo institucioneve të tjera. Ka nga ata që mendojnë se ju personalisht mund të kishit bërë diçka më shumë. Ju akuzojnë se heshtët, mbyllët sytë dhe bëtë sikur nuk e patë realitetin. A mendoni se mund të kishit bërë diçka tjetër, ndryshe, po të ktheheshit pas?**

Gjatë këtyre ditëve po mblidhja të gjitha shënimet e mia nëpër kuti, duke qenë se po zhvendosem dhe është faktikisht një nga çështjet ku mendoj se, së bashku me kolegët e mi nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, por edhe me kolegët amerikanë kemi bërë shumë punë dhe mendoj se rezultatet po ashtu mund të shihen. Ju jeni gazetar dhe e dini që ajo çfarë ndonjëherë është në hapësirën publike dhe realiteti jo domosdoshmërisht përkojnë, kështu që kur bëhet fjalë për luftën kundër krimit të organizuar dhe për gjithçka që kemi bërë, kemi bërë më shumë sesa ajo që mendoja në fillim se do të ishte e mundur të bëhej, duke pasur parasysh problemin. Jam po ashtu mjaft krenare për punën, vëmendjen, fokusin, shtysën dhe të gjitha llojeve të energjive që u angazhuan për trajtimin e kësaj çështjeje. Shqipëria nuk erdhi në këtë fazë pa arsye. Shqipëria arriti në këtë fazë, për shkak të rezultateve të disa çështjeve kyçe, që janë me rëndësi për Bashkimin Evropian. Njëra prej tyre ishte gjyqësori dhe e dyta lufta kundër krimit të organizuar dhe mendoj se ka shumë vlerësim se vendi është në rrugën e duhur, por ka ende një punë të jashtëzakonshme për t'u bërë. Megjithatë kam ruajtur me zell të gjithë korrespondencën dhe shënimet e mia nga të gjitha takimet dhe, tani që po i shihja, kuptova se çfarë kemi bërë.

**Në korrik ju surprizuat, gati, opinionin publik duke pritur në një takim një grup të protestuesve, aktorë, përfaqësues të shoqërisë civile, për sa i përket çështjes së godinës së Teatrit Kombëtar. Keni deklaruar, gjithashtu, se keni kërkuar ekspertizë ligjore nga Brukseli në lidhje me këtë çështje, ndërkohë që ne dimë se edhe Komisioni i ka drejtuar disa pyetje Qeverisë shqiptare. A keni krijuar një ide se si qëndrojnë gjërat?**

Për momentin, shërbimet tona janë ende duke shqyrtuar disa detaje lidhur me këtë

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli,
***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës
së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

### Deputetët rikthehen në Kuvend, dy nismat ligjore që do tensionojnë situatën

# Teatri dhe magjistratët, konflikti i ashpër PD-PS

## *Me 13 shtator, rikthehet dekreti i Metës*



Valentina Madani

Kuvendi rifillon punën pasditen e së hënës ku pritet të nisë me debate të forta mes pozitës dhe opozitës. Të majtë e të djathtë do rinisin betejën politike në Sesionin e III-të të Legjislaturës së IX-të. Por gjatë paradites së 3 shtatorit, PD dhe PS do mbledhin grupet parlamentare për axhendën e pasdites ndërkohë që kreu i opozitës, Lulzim Basha do të mbledhë edhe aleatët e tij në selinë e PD-së për të unifikuar qëndrimin në Kuvend. Edhe pse seanca e së hënës procedurisht është thjeshtë një takim mes deputetëve ku do njoftohen projektligjet e depozituara në Kuvend dhe do të miratohet kalendari i punës, debatet nuk do të mungojnë. Në faqen zyrtare të Kuvendit është publikuar projektkalendari tri-javor i punimeve për periudhën 3-21 shtator. Sipas kalendarit, më datë 13 shtator në Kuvend do të rikthehet për rishqyrtim ligji për "Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar". Për diskutime do të mblidhet edhe Komisioni përkatës ai për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Ligji për Teatrin Kombëtar, u kthye në Kuvend për rishqyrtim nga presidenti Ilir Meta. Sipas presidentit, ligji shkel parimet e barazisë dhe nuk është në harmoni me parimet kushtetuese. Ligji cenon parimet e Konventës Evropiane të Trashëgimisë Kulturore, thuhet mes të tjerave në njoftim. Presidenti Meta ka renditur 9 pika sipas të cilave, projektligji për teatrin duhet rishqyrtuar në parlament duke ngritur si shqetësim edhe mungesën e Gjykatës Kushtetuese. Me shumë gjasa shumica socialiste do të rrëzojë dekretin presidencial, për t'i hapur më pas rrugë zbatimit të ligjit ashtu siç eksponentë të saj kanë deklaruar edhe publikisht.

### MAGJISTRATËT

Një tjetër nismë që do të hidhet për votim në seancë është ligji për magjistratët e rinj, që synon plotësimin e vendeve vakante në sistemin e drejtësisë nga të shkarkuarit për shkak të vetingut. Projektligji kërkon votën e të paktën 84 deputetëve, numër të cilin mazhoranca nuk e zotëron. Përgjatë javëve të fundit të korrikut, para mbylljes së sesionit të kaluar socialistët u orvatën të merrnin mbështetje të paktën nga ishaleatët e LSI-së, por s'ia dolën dot të gjenin emëruesin e përbashkët me ta. Prioritet në sesionin e ri do të jetë edhe reforma zgjedhore, e cila kërkon konsensus politik. Mazhoranca nga njëra anë kërkon me ngulm ligjërimin e votimit të emigrantëve në votime, ndërkohë që opozita këmbëngul në zbatimin e votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhje. Socialistët rëndësi i kanë dhënë edhe depolitizimit të administruesve të zgjedhjeve, por pa specifikuar nëse do të përqendrohen vetëm në komisionet e niveleve të dyta e të treta, apo do kërkojnë shtrirjen edhe në kupolën drejtuese të procesit, KQZ.




**NISMA**

Një tjetër nismë që do të hidhet për votim në seancë është ligji për magjistratët e rinj, që synon plotësimin e vendeve vakante në sistemin e drejtësisë nga të shkarkuarit për shkak të vetingut. Projektligji kërkon votën e të paktën 84 deputetëve, numër të cilin mazhoranca nuk e zotëron.

**DREJTESIA**

"Është përherë sfidë të nisësh diçka nga fillimi, por është shumë e nevojshme, ndaj u jam, gjithashtu, mirënjohëse të gjithëve atyre që janë të gatshëm të marrin përsipër përmbushjen e këtyre funksioneve dhe të ndihmojnë realisht për krijimin e sistemit të mirëfilltë gjyqësor në Shqipëri dhe mendoj që ata mund të jenë vetëm krenarë për veten",-u shpreh ambasadorja e BE në Tiranë.

ligj. Kam folur me kolegët e mi në Bruksel dhe shpresoj që shumë shpejt shërbimet do të vijnë me përgjigje mjaft precize, pasi kishte disa çështje dhe ata donin të bënin disa pyetje shtesë. Fakti që ishte verë dhe pushim nuk ndihmoi, pasi shumë njerëz nuk ishin në punë, por siç e thashë, kam kontaktuar dhe ata do të dalin me një reagim. Kjo është një çështje që ka të bëjë me konkurrencën, me çështjet e prokurimit dhe mendoj që është më mirë për të gjithë të tregojnë pak durim e të presin Komisionin Evropian dhe drejtoritë e përgjithshme përkatëse që të japin vlerësimin e tyre për këtë ligj. Një gjë për të cilën jam vërtet e lumtur është se, kur Shqipëria të çelë negociatat, këto situata nuk do të mund të ndodhin, pasi të gjitha ligjet që do të duhet të miratohen në parlament, duhet të kalojnë më së pari nga Brukseli për t'u shqyrtuar nëse janë në përputhje me Acquis dhe me të gjitha standardet më të mira të Bashkimit Evropian. Vetëm pas kësaj do të mund të vijohet me procedurën në parlament. Pra, në një farë mënyre, do të ketë një analizë parandaluese, përpara sesa të krijohen situata të tilla.

**Jeni dakord me Presidentin e Republikës sipas të cilit ligji në fjalë, të cilin presidenti edhe e ktheu, shkel marrëveshjen e stabilizim-asociimit si dhe të drejta të rëndësishme të njeriut, siç është e drejta e pronës?**

Unë nuk kam mendimin tim personal kam mendimin e institucionit dhe sapo ju thashë që duhet të kemi pak më tepër durim, në pritje që institucionet të dalin me vlerësimin e tyre për të gjitha hollësitë e këtij ligji.

**Mund të na thoni çfarë është diçka që nuk ju pëlqen nga mazhoranca apo nga qeveria të cilës do t'i kërkonit apo t'i këshillonit që të bënte ndryshe?**

Unë jam diplomate dhe, si diplomate, do t'ju them cili është mendimi im që rrjedh prej punës sime. Mendoj që për një proces si procesi i integrimit evropian, në mënyrë që një vend të jetë në gjendje të ecë vërtet përpara, duhet të ketë konsensus kombëtar për disa gjëra bazë, por jo konsensus kombëtar me fjalë, por konsensus me vepra. Të gjithë duhet vërtet të bëhen bashkë, si pakica ashtu edhe shumica. Nuk ka rëndësi kush është në opozitë dhe në qeveri, sepse shumë më e rëndësishme është që partitë të kenë individualisht atë që është interesi i këtij vendi. Për mua kjo është afërmendsh. Asnjë vend tjetër nuk ka arritur të përparojë realisht në rrugëtimin evropian në një klimë të ngjashme me atë në Shqipëri. Ato duhet të gjejnë vërtet një mënyrë për ta dashur vendin më shumë, sesa të përfshihen në një klimë shumë të vështirë politike, që, kam arritur të mësoj, se nuk është gjithmonë realiteti i vërtetë. Pra, mendoj që ajo që dëgjohet, që thuhet dhe kjo zhurma që përmenda nuk pasqyron gjithnjë atë që ndodh dhe mendoj se qytetarët shqiptarë meritojnë vërtet që të ketë bashkim rreth disa interesave kryesore kombëtare dhe duhet të lëvizni. Ky është një vend i mrekullueshëm. Ky vend mund të shkëlqejë me shumë shpejtësi. Mendoj do të ishte një gabim i tmerrshëm i partive politike e, do të thosha, i të gjithë spektrit politik, nëse nuk tregojnë më shumë vullnet të mirë për të folur me njëri-tjetrin e për të gjetur zgjedhjen më të mirë për vendin.

**Të njëjtën pyetje kam edhe për sa i përket opozitës. Përtej dialogut, çfarë do t'i këshillonit opozitës të bënte ndryshe?**

Mund t'ju përsëris vetëm të njëjtën gjë. Në jetë duhet të dish si të fitosh dhe të dish si të humbësh, por ajo çfarë ka më shumë rëndësi është respekti ndaj njëri-tjetrit. Politika nuk ka të bëjë me armiq, politika ka të bëjë me ide të ndryshme dhe ndonjëherë është disi e vështirë të kuptohet se cilat janë idetë që diskutojnë, ndaj mendoj se është tejet e rëndësishme për të gjithë ata që duan ta quajnë veten e tyre politikanë e duan të tregojnë dhe provojnë se është vërtet interesi i vendit të tyre ai që kanë në mendje dhe për të cilin punojnë, të mblidhen bashkë, të ulen, të gjejnë zgjidhje; ta vendosin veten dhe interesat e tyre nën ose shumë më poshtë interesave të vendit që përfaqësojnë.

**Tashmë është bërë publik emri i pasardhësit tuaj. Përveç dokumenteve zyrtare, shkresave pa fund që do t'i lini me informacione, a ka diçka, një këshillë për pasardhësin tuaj, që do ta ndanit me publikun?**

Ne jemi njerëz institucionalë dhe përfaqësojmë institucionin, kështu që, në këtë kuptim, pasardhësi im është plotësisht i pajisur me të gjitha informacionet dhe gjithçka që i nevojitet për të filluar menjëherë punën. Gjithkujt që vjen në Shqipëri për të punuar do i thosha se ajo që ju duhet është shumë energji. Duhet të jesh në gjendje të kesh mjaft rezistencë, nëse do të arrish rezultate. Megjithatë, siç ju thashë ky është një institucion dhe gjithçka është e mirëvendosur brenda makinerisë. Ne kemi një organizim mjaft kompleks dhe Bashkimi Evropian është një institucion që ka shumë mekanizma kontrolli dhe, përveçse i uroj shumë fat kolegut tim, ne kemi pasur e do të kemi një sërë mundësish për t'u informuar dhe diskutuar. Në të vërtetë do rezistencë, duhet të kesh shumë energji. Ndonjëherë bëj shaka se, qysh prej fillimit kur erdha në Shqipëri, isha e fiksuar me kohën dhe me faktin që Shqipëria nuk mund të humbte as edhe një minutë më tepër, sepse keni humbur shumë gjatë historisë suaj dhe ndonjëherë ndihesha si në një nga ata filmat, ku trajneri është në dhomat e zhveshjes dhe iu thotë lojtarëve, "Jepi, jepi, jepi", duke i nxitur, pasi ju duhet të rikuperoni mundësitë e humbura dhe kjo kërkon shumë punë. Nuk është e lehtë të përballesh me këtë shkallë reformash. Nuk është e lehtë, se nuk ke kohë për të pushuar, por është absolutisht e nevojshme.

**Mund të na thoni se çfarë do të bëni? Pas Shqipërisë ku do të shkoni, nëse keni një detyrë të re?**

Kamioni me gjërat e mia është nisur tashmë për në Bruksel, pra do të shkoj në Bruksel, në selinë e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian. Do të punoj me sekretaren e përgjithshme. Nuk e di nëse shumë dashuri e thatë si kritikë apo si diçka të mirë. Unë e dashuroj punën time dhe nuk do të isha kurrë në gjendje ta bëja si duhet, nëse nuk do e doja. Për mua nuk është çështje emocionesh, është çështja të japësh gjithçka je, gjithçka di, gjithçka mundesh dhe gjithë vullnetin e mirë që ke për rezultatin që do të arrish.

QEVERISJA
PROJEKTET

Kryeministri në Vlorë për bilancin, mësimet dhe objektivat për sezonin e ardhshëm turistik

# Negociatat për aeroportin e Vlorës, Rama: Gjithçka për interesin publik

## "Bypasi i Fierit na është bërë si bypasi i fytit"

Qeveria shqiptare po vijon negociatat për ndërtimin e aeroportit të Vlores, të cilat kryeministri Edi Rama i cilësoi të vështira, pasi siç tha ai, "duam të marrim maksimumin për interesin publik dhe të shtetit". Prezantimin e arritjeve të këtij sezonit turistik kryeministri ua besoi ministrave gjatë një takimi në Radhimë të Vlorës. Sfidat e radhës për kryeministrin Edi Rama mbeten përpunimi i ujërave të zeza që vijojnë të derdhen në det, si dhe furnizimi me ujë të pijshëm i zonave bregdetare. Kreu i qeverisë u shpreh optimist edhe për fillimin së shpejti të punimeve për aeroportin e Vlorës. Në takimin e zhvilluar në Vlorë për sezonin turistik, kryeministri u shpreh se "jemi në proces negociatash për ndërtimin e aeroportit të Vlorës". "Ndryshe nga çfarë u propagandua nuk ishte një pazar i mbyllur, por është një negociatë e vështirë, sepse ne duam të marrim maksimumin për interesin publik dhe të shtetit", theksoi z.Rama. Kryeministri u shpreh besimplotë se do ta mbyllim negociatën dhe do të fillojmë edhe punën për të ndërtuar aeroportin e Vlorës. "Pastaj aty do të fillojë një sfidë tjetër për Vlorën sepse ndryshimi i flukseve do të jetë shumë i madh dhe nevojat e jashtëzakonshme për të rritur cilësinë e shërbimeve po ashtu. Në mbi 20 vjet këtu janë bërë investime të gabuara, pasi nuk kemi hotele të mirëfillta dhe vila të mirëfillta turistike, kemi shumë pak",- deklaroi kryeministri.

**PROJEKTET**

Kryeministri Edi Rama teksa u ndal tek objektivat për sezonin e ardhshëm turistik foli edhe për bypasin i Fierit. Ndërsa po tregonte për projektet për të ardhmen, kryeministri ndërpreu fjalën dhe tha: "E kam shumë të qartë që ndërkohë që ne flasim aty vazhdojnë komentet po bypasi i Fierit, po bypasi i Fierit, i cili na është bërë si bypasi i fytit nga sikleti. Sinqerisht përditë në fyt nga sikleti, sepse realisht është një legjendë katastrofike paaftësie, papërgjegjshmërie dhe korrupsioni. Na është dashur të prishim komplet kontratën dhe të bënin gjithçka nga e para me Bankën Europiane për Zhvillim. Tani procesi ka filluar dhe shpresojmë shumë që brenda disa javëve të na vijë përgjigja përfundimtare e bankës, të lidhet kontrata dhe sezonin e ardhshëm ta gjejë rrugën e bypasit të hapur për të qenë e kalueshme, nëse jo e përfunduar tërësisht. Kështu të kompletohet e gjithë lidhja me Vlorën", tha z.Rama. Më pas ai foli dhe për rrugën Kashar- Rrogozhinë që e bën Tiranë-Vlorë për 55 minuta dhe premtoi se bulevardi i ri i Vlorës sezonin e ardhshëm do jetë gati. "Pak më tutje vjen projekti i tjetër rrugës Kashar- Rrogozhinë që e pret komplet në diagonal rrugën drejt Fierit e Vlorës dhe e bën Tiranë-Vlorë për 55 minuta. Më vjen mirë që sidoqoftë vlonjatët nuk po nxjerrin zë për bulevardin e ri ku është bllokuar trafiku dhe është ngushtuar rruga. Bulevardi i ri do të jetë një tjetër vlerë e shtuar. Në sezonin e ardhshëm do ta kemi të përfunduar besoj dhe do të jetë realisht një tjetër vepër si Lungomarja për të cilën marrim mesazhe inkurajuese", theksoi z.Rama.


Kryeministri Edi Rama

**FATMIR XHAFAJ**
"Ne premtuam 3 muaj më parë në nisje të këtij sezoni se do të kishim një sezon me shumë qetësi dhe shume rend, si dhe parandalimin e akteve kriminale. Ky ishte një sezon i sigurt dhe pa pasoja në zonat turistike, si dhe me një ulje të ndjeshme të vjedhjeve në territoret e plazheve",- theksoi Xhafaj.

**LUÇIANO BOÇI**
Deputeti demokrat Luçiano Boçi tha se në procesin e pranimeve në universitet vazhdon i njëjti kaos dhe të njëjtat dallavere dhe se nxënësit turren të marrin një degë edhe pse e dinë që është pa vlerë pasi këtu nuk ka as të ardhme e as punë. Për këtë situatë ai akuzon ministren e Arsimit.

**BETONIZIMI**
PD publikoi dje një video nga AKPT, e cila sipas tyre vërteton edhe një herë planin e betonizimit të liqenit. Zëdhënësja Ina Zhupa, ka akuzoi kryeministrin Rama dhe kryebashkiakun Veliaj se po përgatiten për betonizimin e Liqenit Artificial në Tiranë. Zhupa tha se "sipas planit të Veliajt, ndërtesat do të jenë mbi 9 kate e 29 metra lartësi tek Parku i Liqenit".

## Meta me turistët nga Izraeli: Kemi nevojë për teknologjinë izraelite



Presidenti, Ilir Meta priti dje një grup turistësh nga Izraeli, të cilët ishin të shoqëruar nga ambasadori i Izraelit Boaz Rodkin si edhe ish-ambasadori i Izraelit, David Cohen. Meta kërkoi marrëdhënie më të ngushta duke e vënë theksin tek teknologjia izraelite. Gjatë takimit, që kishte për qëllim promovimin e turizmit, kulturës e traditave shqiptare, Presidenti Meta i njohu të pranishmit me mundësitë e shkëlqyera që ofron vendi ynë në turizëm. Kreu i shtetit theksoi se fokusi i forcimit të marrëdhënieve dypalëshe duhet të vendoset tek ekonomia dhe turizmi, teksa shtoi se Izraeli ka një potencial të jashtëzakonshëm për të qenë pjesë e zhvillimeve ekonomike të Shqipërisë.

## Denoncimi, Berisha: Mbyllen 7 shkolla në Vlorë

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një denoncim nga një mësues nga Vlora, i cili shpreh shqetësimin e tij, pasi 7 shkolla të ciklit 9-vjeçar në Vlorë janë lajmëruar që do të mbyllen. Berisha ngre shqetësimin për nxënësit që tashmë do të duhet të shkojnë më larg për të mësuar. "Dje (të premten) rreth orës 13 DAR Vlorë me anë të 1 mbledhjeje të papritur na ka komunikuar mbylljen e 7 shkollave të ciklit 9-vjeçar, të cilat ishin me klasa kolektive. Pothuajse të gjithë prindërit e fëmijëve që po u mbyllen shkollat nuk kanë ndërmend që t'i çojnë më në shkollat-qendër fëmijët pasi janë larg. Disa prej shkollave janë: Dukat i Vjetër, Tragjas, Radhimë, Sherishtë, Mekat, Kërkovë. Do mundohem sot t'ju nis dhe vendimin të shoqëruar me listat e mësuesve që hidhen në rrugë që janë më shumë se 40 mësues. Pa asnjë vendim të ministrisë dhe pa asnjë lloj strategjie konkrete se ku dhe si do venë këta nxënës në shkollë",- thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha.


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje programesh Software për nevojat e Bankës se Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3.581.600 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje programesh Software për nevojat e Bankës se Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 02 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**Njoftim për shitje me ankand**

**Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k** do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorezanesin K S te ndodhura ne fshatin Panahore. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :
"Pasuria "Are" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me siperfaqe 2500 m2 ZK 2869 me cmim 1.200.000 lekë
"Pasuria "Are" nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmim prej 80.000 lekë
"Pasuria" me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me siperfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me çmimin në masën 400.665 lekë
**Ankandi eshte progresiv e do të zhvillohet dt 13.09.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont tel. 672082543, e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com**

Tatimet: Çfarë ndryshon në taksën e kalimit të së drejtës së pasurisë, lehtësi për ndërtuesit

# Shitblerja e shtëpive, Tatimet: Ja sa paguajnë pronarët

## *Formula e tatimit për individët: Vlera në shitje - vlerën në blerje x 15%*

Ornela Manjani

Tatimet zbardhet formulën dhe procedurat që do të ndiqen në rastet e shitblerjes së ndërtesave dhe truallit për taksën e kalimit të së drejtës së pasurive të paluajtshme. Madje rastet janë të shoqëruara me shembuj për të bërë në të kuptueshme zbatimin e taksës. Formula e tatimit për individët është vlera në shitje minus vlerën në blerje herë 15%. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, tokë (truall apo tokë bujqësore) dhe ndërtesë, tatohet 15 për qind të fitimit kapital të realizuara. Individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, paguan tatimin para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të pasurisë, në përputhje me aktet dhe procedurat ligjore në fuqi. Pasuria e paluajtshme e kaluar, nuk regjistrohet pa provuar pagimin e këtij detyrimi pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Me kalim të së drejtës së pronësisë, kuptohet akti i shitjes, dhurimit apo heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme. Me termin "fitim kapital i realizuar", kuptohet diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të ndërtesës ose tokës. Vlera në shitje e pasurisë së paluajtshme, përcaktohet në kontratën noteriale të shitjes, e cila është nënshkruar nga palët (shitësi dhe blerësi). Kontrata duhet të shprehë sipërfaqen në metër katror të pasurisë objekt të kontratës, çmimin për metër katror dhe vlerën e saj. Kontrata duhet të jetë e shoqëruar me hartën, planimetrinë dhe dokumentet e tjera, që shërbejnë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

### TATIMET

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, njofton tatimpaguesit se në Fletoren Zyrtare nr.125, u publikua udhëzim i përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme", i cili shfuqizoi udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar. Ky udhëzim vjen më i plotë në trajtimin dhe përfshin pothuajse të gjitha rastet hipotike të transaksioneve të kalimit të pronësisë, duke ilustruar me shembuj konkretë mënyrën e përllogaritjes së taksës së kalimit të pronësisë dhe tatimit të kalimit të së drejtës së pronësisë që llogaritet si tatim mbi fitimet kapitale. Risitë që sjell ky udhëzim kanë të bëjë kryesisht me disa saktësime. Sipas njoftimit mësohet se investitorët në biznesin e ndërtimeve, të cilët janë regjistruar në organet tatimore si persona juridikë, (shoqëri tregtare) me objekt ndërtimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme, nuk janë subjekt i "tatimit" mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme. Ata janë subjekt pagues vetëm të "taksës" vendore mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Në njoftim saktësohet se investitorët në biznesin e ndërtimeve, të cilët janë regjistruar në organet tatimore si subjekte me status "person fizik tregtar", janë subjekt i "tatimit" mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme. Ata janë, gjithashtu, subjekt pagues të "taksës vendore" mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.



### VLERA E SHITJES

Për sa i përket vlerës në shitje të pasurisë së paluajtshme, ajo përcaktohet në kontratën noteriale të shitjes, e cila është nënshkruar nga palët (shitësi dhe blerësi). Sjellim në vëmendje se: kur pronësia e pasurisë së paluajtshme kalohet për herë të dytë e në vazhdim, për efekt të llogaritjes së fitimit kapital të realizuar do të merret diferenca midis vlerës së shitjes së fundit dhe vlerës së blerjes e përcaktuar në kontratën paraardhëse të kësaj pasurie. Pra, në momentin e transaksionit të shitblerjes së një pasurie të paluajtshme aplikohen: taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë së paluajtshme dhe tatimi mbi të ardhurat personale nga kalimi i të drejtës së pronësisë së paluajtshme. Agjenti i taksës dhe i tatimit mbi të drejtën e kalimit të pronësisë është zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, e cila kalon të ardhurat e mbledhura në favor të pushtetit vendor dhe administratës tatimore brenda afateve të përcaktuara në ligj.

### LLOGARITJA E DETYRIMIT TATIMOR:

**Vlera në shitje e truallit rreth ndërtesës sipas hartës së vlerave është:**
300 m2 x 246 lekë/m2 = 73 800 lekë
Vlera në blerje e truallit
Duke qenë se trualli është përfituar sipas VKKP-së në vitin 2007, vlera në blerje është:
300 m2 x 246 lekë/m2 : 1.284 (indeksi i vitit 2007) = 57 477 lekë
**Detyrimi tatimor që duhet të paguajë për truallin shitësi AA është:**
(vlera në shitje - vlerën në blerje) x 15 %
(73 800 - 57 477) x 15 % = 2 448 lekë
Detyrimi tatimor gjithsej është:
(detyrimi tatimor për ndërtesën + detyrimi tatimor për truallin)
257 610 lekë + 2 448 lekë = 260.058 lekë
**Shembull nr. 1:**
Shoqëria e ndërtimit "Helena" sh.p.k., i ka shitur individit AA një apartament me vlerën 5 000 000 lekë. Individi AA ia shet këtë apartament individit BB në vitin 2015, me kontratën e shitblerjes datë 9.1.2015 me vlerën 6 000 000 lekë.
Individi AA do të tatohet me 15% të diferencës midis vlerës së shitjes 6 000 000 lekë dhe vlerës së blerjes 5 000 000 lekë. Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje - vlerën në blerje) x 15% (6 000 000 - 5.000.000) x 15 % = 150 000 lekë
Shënim. Vlera në shitje e pasqyruar në kontratën e shitjes, do të kontrollohet me vlerën sipas çmimeve të tregut të lirë të përcaktuar në aktet përkatëse nënligjore. Në rastet e shitjes së ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, çmimi minimal i shitjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet për sa më poshtë:
♦ Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një e gjysmë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.
♦ Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
♦ Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur është 30 për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
♦ Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.
♦ Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
♦ Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky reduktim është 30 për qind krahasuar me çmimin e zonës më të afërt.
e) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë. Nëse vlera e llogaritur sa 70% e çmimeve të referencës sipas zonave të tabelës është përdorur njëherë, qoftë dhe në rivlerësimin e pasurisë, në vijim nuk do përdoret më si çmim reference.

### SHEMBUJ

**Shembull nr. 2:**
Individi AA në qytetin e Durrësit ka në pronësi të tij një apartament me sipërfaqe 70 m2 të blerë me kontratë shitblerje në vitin 2002 me vlerë 2 900 000 lekë. Individi AA në vitin 2013 ka bërë rivlerësimin e pasurisë në sportelet e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), në shumën 5.180.000 lekë. Në vitin 2014 individi AA ia shet apartamentin e tij individit BB në vlerën 4 000 000 lekë me kontratën e shitblerjes të datës 27.8.2014. Llogaritja e detyrimit tatimor që duhet të paguajë shitësi AA: Për të përcaktuar vlerën në shitje, kontrollojmë vlerën e pasurisë në shitje me çmimet e referencës. Vlera në shitje e ndërtesës sipas çmimeve të tregut të lirë (viti 2014) është: 70 m2 x 74 000 lekë/m2 = 5 180 000 lekë. Duke qenë se vlera sipas udhëzimit "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014" është me e madhe se ajo në kontratën e shitjes, si vlerë në shitje për llogaritjen e tatimit merret vlera më e madhe. Vlera në blerje është vlera sipas rivlerësimit të pasurisë: 5 180 000 lekë.
**Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është:**
(Vlera në shitje - Vlerën në blerje) x 15 % (5 180 000 - 5 180 000) x 15 % = 0 lekë Individi BB këtë apartament ia shet blerësit CC me kontratën e shitblerjes datë 13.1.2015 në shumën 5 180 000 lekë.
**Llogaritja e detyrimit tatimor që duhet të paguajë shitësi BB:**
Për të përcaktuar vlerën në shitje, kontrollojmë vlerën e pasurisë në shitje me çmimet e referencës. Vlera në shitje e ndërtesës sipas çmimeve të tregut të lirë (viti 2014) është: 70 m2 x 74 000 lekë/m2= 5 180 000 lekë. Duke qenë se vlera sipas tregut të lirë është e barabartë me atë në kontratën e shitjes, për llogaritjen e tatimit merret vlera në kontratën e shitjes (5 180 000 lekë).
Vlera në blerje është vlera sipas kontratës paraardhëse, pra 4 000 000 lekë (vlera me të cilën e ka blerë apartamentin individi BB).
**Tatimi që duhet të paguajë shitësi BB është:**
(vlera në shitje - vlerën në blerje) x 15 % (5 180 000 - 4 000 000) x 15 % = 177 000 lekë
**Shembull nr. 3:**
Një individ AA, në qytetin e Vlorës, në datën 15.1.2015 i shet blerësit BB apartamentin me sipërfaqe 60 m2, me vlerë 3 000 000 lekë, vlerë e cila është pasqyruar në kontratën e shitjes. Llogaritja e detyrimit tatimor që duhet të paguajë shitësi AA: Për të përcaktuar vlerën e pasurisë në shitje, kontrollojmë vlerën e pasurisë në shitje me çmimet e referencës që kanë qenë në fuqi në atë vit sipas udhëzimit "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015". Vlera në shitje e ndërtesës sipas çmimeve të tregut të lirë është: 60 m2 x 61.655 lekë/ m2 = 3.699.300 lekë. Duke qenë se vlera në shitje sipas referencës është më e madhe se ajo në kontratën e shitjes, atëherë për llogaritjen e tatimit do të marrim si vlerë në shitje, vlerën e përllogaritur sipas referencës pra, vlerën 3 699 300 lekë (vlera në shitje). Shitësi AA e ka blerë apartamentin e tij para dy vjetësh me vlerën 2 100 000 lekë (vlera në blerje).
Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje - vlerën në blerje) x 15% (3 699 300 - 2 100 000 ) x 15 % = 235.395 lekë.
**Shembull nr. 4:**
Një individ AA, në qytetin e Librazhdit, me kontratë shitje në datën 15.01.2015 i shet blerësit BB një dyqan (njësi tregtimi) me sipërfaqe 60 m2, me vlerë 3 000 000 lekë, vlerë e cila është pasqyruar në kontratën e shitjes. Llogaritja e detyrimit tatimor që duhet të paguajë shitësi AA: Për të përcaktuar vlerën e pasurisë në shitje, kontrollojmë vlerën e pasurisë në shitje me çmimet e referencës. Vlera në shitje e ndërtesës sipas çmimeve të referencës është: 60 m2 x 44.020 lekë/ m2 x 1.5 = 3 961 800 lekë Duke qenë se vlera në shitje sipas referencës është më e madhe se ajo në kontratën e shitjes, atëherë për llogaritjen e tatimit do të marrim si vlerë në shitje, vlerën e përllogaritur sipas referencës, pra vlerën 3 961 800 lekë (vlera në shitje). Shitësi AA e ka blerë dyqanin (njësinë e tregtimit) nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit (AKP) me kontratë shitblerje në datën 5.11.1992, me vlerë 250 000 lekë (vlera në blerje). Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje - vlerën në blerje) x 15%(3 961 800 - 250 000 l) x 15 % = 556 770 lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPËRFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META
**ÇMIMI 4.118.696 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 13.09.2018**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866** .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA E LLOJIT 'PYLL + KULLOTË', ME SIPËRFAQE 190.000 M2, ZONA KADASTRALE 3028, ME ADRESË: PORO VLORË, NË PRONËSI TË Z. FATION UKA.
**ÇMIMI 1.824.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 15.09.2018.**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C**

*-Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane* **.Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Leke.**

Data e shpalljes 01.08.2018
Data e zhvillimit 05.09.2018 deri ne oren 16.00
**Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.**

Detyrimet e prapambetura, 21 mijë biznese në sekuestro

# Tatimet: Ja si të paguani me këste detyrimet

## Tre hapat që duhet të ndjekin subjektet

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton tatimpaguesit në lidhje me kushtet dhe detyrimet sipas së cilave lidhet një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet tatimore të papaguara. Tatimpaguesi, për të përfituar nga kjo lehtësi duhet të justifikojë paaftësinë likuiduese të përkohshme financiare. Numri i bizneseve që janë debitur nga tatimeve arrin deri në 21 mijë. Madje pak ditë më parë tatimet njoftuan se do të nisin mbledhjen me forcë të detyrimeve, aksion i cili mund të çojë deri në sekuestro të llogarive bankare e aseteve.



**MARRËVESHJA**

Marrëveshja me këste nuk mund të zgjatet përtej fundit të vitit që pason vitin në të cilin është lidhur ajo. Në rastet e marrëveshjeve për pagesë me këste, tatimpaguesi paguan kamatëvonesat, por nuk llogaritet gjobë për pagesë të vonuar. Marrëveshja për pagesë me këste nuk mund të lidhet për detyrimin tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Tatime të një natyre të tillë, por pa u kufizuar vetëm në to, përmenden: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Tatimi i mbajtur në burim, Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore. Ndonjë lloj takse e cila llogaritet, mblidhet e mbahet nga tatimpaguesi. Hapat që duhen të ndiqen për të nënshkruar një marrëveshje me këste janë: kërkesë me shkrim drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore nën juridiksionin e të cilës është regjistruar. (Shpjegoni rrethanat dhe arsyet pse kërkohet të lidhet një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet tatimore). Drejtoria Rajonale Tatimore brenda 10 ditëve njofton nëse kërkesa pranohet apo refuzohet. Nëse kërkesa pranohet, nënshkruhet marrëveshja për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara. Kjo marrëveshje nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve ose drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, vetëm nëse tatimpaguesi paguan menjëherë 20% të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja e pagesës me këste. Administrata Tatimore ndërpret masat e mbledhjes me forcë, të mbledhjes së detyrimeve tatimore, por ajo nuk tërheq masën e vendosur për të siguruar pagesën e detyrimit tatimor. Nënshkrimi i një marrëveshje për pagesën me këste të një detyrimi tatimor, nuk ndërpret llogaritjen e kamatëvonesave për mospagim në afat të detyrimit tatimor të mbetur pa paguar. Tatimpaguesi, ndaj pasurisë së të cilit ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë qoftë në formën e barrës së sigurisë apo barrës hipotekore, në rastet kur pretendohet se zbatimi i masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt, ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore.

## AKU bllokon 55 tonë miell gruri nga Kosova e Serbia

Duhej të ishte 60 vjeç më 2 Shtator të vitit 2018. Porse vdekja e ndau vite më parë dhe shumë ndryshe nga njerëz, që janë ndarë nga jeta në fushën e tij, ai vazhdon të mbahet mënd dhe të dialogojë qoftë dhe nga hiçi. Siç ndodh zakonisht pas vdekjes dhe sidomos në përkujtime flitet me panegjirizëm dhe për atribute, që i ndjeri nëse do t'i dëgjonte do të shkulesh së qeshuri ose në rastin e Dorit, thjesht do të ikte dhe do ta kthente në një subjekt humoristik, por gjithçka mbledhur në trishtimin e madh që mbarte dhe që sidomos iu shfaq në kohët e fundit. Keko ishte pajtuar me fatin e tij...

*Të lehtë në trup e kam ndërgjegjen.*
*Dhe që mos kthehem më kurrë pas*
*do marr me vete vetëm vdekjen.*

Dori u bë i njohur veçanërisht pas viteve '90, kohë kur socializimi i tij me mjedisin kishte një kah, që të çonte direkt tek miqësia dhe shoqëria ndryshe. Hokat, qesëndia dhe mbi të gjitha ato që mundoheshin të hidhte në letër tregonin një njeri të dhënë pas letërsisë, por më shumë një qenie, e cila nuk mund të ishte dakord me rrugën që po përshkonte shoqëria shqiptare në këtë stad të ri të vendit të tij. Notat ekzistenciale të kohës së tij janë më shumë sens për të përcjellë frymën që i shkon natyrës së problematikës që e shoqëron ngado jetën e vet. Për ata që e kanë njohur më afër, paradoksalisht ka shumë, lufta më e madhe me Dorin ishte me veten e vet me paqartësitë që i mbarte Uni dhe ekzistenca në këtë rendi të ri. Ndaj dukej sikur ngutej të shkruante dhe shkruante pafund.

Ai ishte pjesë e atij brezi, që regjimi i kapi në kapërcyell të dy kohëve, njëra me privacionet dhe me mungesën totale të lirisë së shprehjes dhe eksplorimeve të nënvetëdijes në komunizëm dhe tjetra më pas në atë që jetojmë dhe që ai jetoi pjesërisht e ishte realisht një mishelinë sistemi ekonomiko-social. Ndaj personazhi i tij përmbledh të gjithë këtë turmë të vrarë, e cila do të gjejë veten në një gjendje që i ngjan një patologjie vetëvrasëse. Kritikë që nuk e artikulojnë me emër vërejtjen e tyre shprehen nënzë se Dori realisht nuk përbën ndonjë veçanti për letrat shqipe, aman kur vjen puna për ta sqaruar këtë thënie stepen sepse liria dhe mënyra sesi e shprehte veten dhe artin e tij, në çfarëdo rangu, ende i qesëndis nga pas. Në fakt, ai përjetoi kohën kur e gjithë shoqëria jonë ishte në një krizë të stërmadhe identiteti dhe në një rrugë pa krye.

Por Dori u mundua të dilte mbi këtë situatë dhe ta përshfaqte këtë, me ekzistencializmin e vet të thjeshtë, kuptohet se në një vend me krizë kaq të madhe identiteti nuk mund të bësh më shumë.

*Po shkon një njeri i rrënuar në rrugë,*
*Vdekjen lyp dhe ik Kuturu.*
*S'vret dot veten; S'ka gjak në vena,*
*Zemër në gjoks e në kafkë tru.*

Dhe, për të treguar se mund ta shkonte dhe më tej, bëri diçka që i shkonte ekzistencialistëve të kohës së Shqipërisë post '90, u angazhua. Kryeministri i kohës Ilir Meta e vendosi në një post dhe që nga aty e kemi njohur në një dimension tjetër kur negocionte me artistët në kohën e krizës së madhe që krijoi ministri i Kulturës së asaj kohe Edi Rama. I ndjeri dëgjonte dhe mundohej të orientonte por më shumë se kërkonte orientim nuk arrinte të kthjellonte vetë misionin e tij dhe se çfarë mund të përcillte te qeveria, ku ishte punësuar dhe që nuk i shkonte kjo frymë. Dhe, duket se Dori këtë sens për të qeshur, për të bërë humor nuk i shkon aspak me ndjenjën e vërtetë të vetmisë që e ndjek dhe sidomos vdekjes si element thelbësor, që i shkon frymës më të ndjekur të asaj kohe. Jashtë hokave dhe asaj zhdërvjedhtësie që e bën shumë të dukshëm në shoqëri, ai i jepet krejtësisht vetmisë. Në një farë mënyre, njeriu i shkallës së tij, kishte vetminë më të madhe.

...

Me pak fjalë, Tjetërsimi i jetës së tij prej gjendjes ku kalonte shoqëria bashkë me të dhe sëmundjes e ka nisur diku ku tashmë e dinte mirë shortin e tij. Pasi jetonte prej vitesh me të. Koha e ka marrë me vete dhe pothuaj se ka harruar si të vdekurit e shumtë, sepse Dorin e kemi gjithnjë, qoftë edhe kur nuk komunikojmë, bashkë edhe me një grup jo të vogël...që tregojnë edhe shumë gjëra që kinse i atribuohen atij. Dori do të ishte 60 vjeç më...2 Shtator.

# E
## EPISTOLAR

*Kjo është një nga letrat që bashkëshortja e Teodor Kekos i bën të ndjerit herë pas here dhe që janë plani i një botimi, i cili do të vijë së shpejti...*



**Dori im i dashur,**

Kam disa kohë pa të shkruar, e di, por unë çdo mbrëmje bisedoj me ty. Pasi mbyllet dita dhe bëhem gati për gjumë sigurisht që mendimi shkon te gjërat që kanë shkuar mirë ose jo, apo tek ato që priten të ndodhin. Gjithnjë pyes veten se si do kishte vepruar Dori po të ishte në vendin tim dhe sinqerisht shpesh e marr përgjigjen e duhur.

Do të doja që të mos kisha nevojë të shkruaja këtë letër në prag të ditëlindjes tënde të 60-të por të isha e okupuar bashkë me djemtë për përgatitjen e një feste surprizë për ty. Pastaj, do të doja që në ditëlindjen tënde të të thosha plot gjëra Dori, duke të parë në sy… Të tregoja për Teon e vogël që mban emrin tënd, për Martinin që tashmë është shoku im më i mirë, për Elion, dikur aq të përkëdhelur, që është bërë një baba i kujdesshëm, që i jep Teos dhe Kitit aq shumë dashuri e mua aq shumë mbështetje shpirtërore.

Çfarë të të them më o Dori në këtë përvjetor tëndin?... Kanë kaluar plot 16 vjet nga ikja tënde e, çdo ditë që shkon më mungon më shumë mua dhe fëmijëve, çdo festë jona është e trishtë pa ty, çdo ardhje në Tiranë është dhimbje sepse e bën edhe më evident faktin që ti nuk je më, çdo kafe në kafenenë tënde të preferuar është e pabukur. E vetmja gjë e bukur që mund të të them është faktí se të gjithë të kujtojnë: miqtë, të afërmit, lexuesit e tu të shumtë. E kjo, pavarësisht se më bën të mos ndihem krejtësisht vetëm por të të kem pranë në 100 mënyra, sërish nuk mjafton për të gjetur forca e festuar ditëlindjen tënde përveçse të të sjell një buqetë të madhe me lule, dy gota konjak për ne të dy, e për të ndezur nga një cigare duke biseduar…

Të të them një sekret… e di ku po e shkruaj këtë letër…. jam buzë liqenit në Pogradec, pikërisht në hotelin ku kaluam muajin e mjaltit. Natyrisht hoteli ka ndryshuar shumë por dhoma ime është pothuajse mbi liqen, njësoj si atëherë. Edhe Pogradeci ka ndryshuar por për mua do të mbetet përherë ai qyteti i vogël e i ëmbël ku u ngjiz Martini. Të gjithë qeshin kur u tregoj se djali i madh, tashmë 33 vjeç, është produkt i pastër i peshkut belushk dhe shumë gotave verë të prodhuar në Pogradec, shijuar nga ne në verën më të bukur të jetës sime, atë të vitit 1984.

Përpara se ta mbyll dua të të tregoj për Teon, i cili e ka ndryshuar e gëzuar jetën tonë. Mua më duket, siç çdo gjysheje, fëmija më i ëmbël në botë. Është një ndjesi që nuk e kisha provuar në jetë, dashuri sublime. Shpesh Kiti qesh me mua e më thotë: "Më duket se ke rënë në dashuri me këtë burrin e vogël". Sa herë e shoh dhe e përkëdhel të kujtoj ty, më vjen mirë që mban emrin tënd por besomë aq keq që nuk u takuat kurrë, megjithëse jam e sigurtë që do jetë krenar për gjyshin e tij. Sa herë i tregoj përralla, gjithnjë në shqip sepse jam e vendosur t'i mësoj gjuhën tonë, në fund i them se sa bukur do të ishte sikur këto përralla të t'i tregonte gjyshi Dori dhe besomë më sheh me ato sytë e tij të mëdhenj blu dhe buzëqesh thua se më kupton.

Po iki përpara se të të trishtoj jetën tënde tashmë të paqtë me përditësinë time tokësore të mbushur me mungesën tënde.

Të dua shumë,
Xhuli

***Pogradec më, 28 gusht 2018***

*Ky tregim është një prej krijimeve të fundit të Teodor Kekos. Thuajse një vit para se të vdiste. I shkëputur nga botimi "Amaneti", botimet "Toena", tregimi "Një kukull që nuk është kukull", na sjell një prej frymëzimeve të fundit të Kekos, të cilat ai i la në dorëshkrim dhe nuk arriti t'i shihte të botuara*

T
TREGIMI

# NJË KUKULL QË NUK ËSHTË KUKULL

NGA TEODOR KEKO

Ishte një ditë e ngrohtë prilli e vitit 1976, kur lindi mes të qarave gërvishtëse një vajzë e bukur, si nëna e saj. Lindja qëlloi e vështirë nga pozicioni ters i foshnjës në bark dhe, me gjithë përpjekjet e ethshme të mjekëve e të mamive, nëna e të porsalindurës dha shpirt, fill pasi nxori në dritë krijesën e saj të parë e të fundit. Kishte humbur shumë gjak dhe nuk mund t'i bëhej një transfuzion i menjëhershëm, pasi grupi i saj i gjakut ishte shumë i rrallë.

Në atë panik, mjekët menduan se si do t'ia jepnin lajmin e kobshëm të afërmve të së ndjerës, por e kishin vrarë mendjen kot. Vetëm kur ata filluan të kërkojnë prindërit e saj, apo bashkëshortin, fillimisht për të kërkuar kampione nga gjaku i tyre e më pas për t'iu dhënë lajmin e tmerrshëm, e kuptuan se adresa e shënuar në bllokun e trashë të regjistrimeve ishte e rreme. Nuk figuronte në asnjë zyrë të gjendjes civile as emri, as adresa e saj. Ajo nuk kishte lënë pas as edhe një shenjëz të vetme orientimi.

Me foshnjën në duar, mamitë u sollën një kohë vërdallë. Foshnja qante, pasi donte të pinte, kështu që, pak nga se nënat e reja kishin nevojë për një thithëse qumështi, që mos t'iu mblidhte gjiri, derisa t'iu sillnin foshnjat e tyre dhe më shumë nga keqardhja për këtë fëmijë të braktisur kaq mizorisht nga fati i mbrapshtë, filluan ta bredhin gji më gji të fryrë, sa herë i tekej të pinte.

Atëherë nuk kishte kushte për t'i strehuar në Shtëpinë e Fëmijës foshnjat e porsalindura, kështu që vajzën e mbajtën dy muaj në maternitet. Kjo foshnjë, e cila çuditërisht nuk bënte naze sa herë ia ndërronin gjirin e kësisoj edhe llojin e qumështit, u bë sakaq fëmija më i dashur për të gjithë.

Pak para se të transferohej në Shtëpinë e Fëmijës, Flora, gruaja e një kirurgu të njohur abortoi për herë të tretë, këtë herë pas gjashtë muajsh shtatzanie e regjimi të rreptë shtrati. Por, mes lotëve, ajo sakaq u kujtua për jetimen e bukur me të cilën kishte nja dy muaj që luante, sa herë që ajo qante dhe mamitë ishin të zëna me urgjenca.

- Pse mos ta adoptojmë ne, – iu lut të shoqit me ankth në sy.

I shoqi druhej mos foshnja ishte sakate, nga ndonjë tentativë e natyrshme aborti e nënës së saj të ndjerë, por, si e vizitoi me kolegët e tij me kujdes, nuk dalloi asgjë shqetësuese te vajza.

- Kjo vetëm sëmundje nuk ka në trup! - i vuri vulën një kolegu i tij.

Kaq mjaftoi për t'ia mbushur mendjen kirurgut.

- Po e marrim ne këtë fëmijë! - e vendosi ai, a thua ndodhej në pazar dhe kështu vajza ndërroi adresë.

Vajzën e quajtën Ema. Ajo rritej mes kujdesit dhe shumë shpejt dha shenjat e një zgjuarsie të mprehtë natyrore. Kishte një karakter të fortë, nuk dorëzohej lehtë dhe, kur të shihte me sytë e saj jeshilë, të turbullonte.

- Si shtrigë më duket! - psherëtinte Flora, që çmendej pas saj dhe i qe bërë si hije trupi.

Në shkollë, Ema dallohej për dy gjëra: për zënkat e egra me kundërshtaret e saj dhe për ecurinë e shkëlqyer në mësime. Derisa mbushi 10 vjeç, fytyrën e kishte gjithmonë plot me gricje, aq sa të kujtonte hartën fizike të botës. Të merrte malli ta shihje të ulej një herë në tavolinë me libër në dorë, megjithatë, askush nuk arrinte rezultatet e saj në mësime dhe, pa mbaruar shkollën 8-vjeçare, vetëm duke dëgjuar radio e parë televizor, kishte përvetësuar shkëlqyeshëm gjuhët italiane dhe angleze.

Duke u rritur, ky fëmijë nisi t'i fitojë një nga një olimpiadat, herë në matematikë, herë në fizikë e herë në kimi. Tmerr i fuste vetëm letërsia. Po të lexonte një libër të kësaj natyre e zinte gjumi sakaq.

Në gjimnaz erdhi e u bë një vajzë e bukur, me trup atleteje, me flokë kaçurrelë të dendur, që nuk kishte krehër t'ia bënte zap. Meshkujt i silleshin vërdallë nëpër këmbë, si minj, dhe ajo filloi të ngalasej nga pak me ta, derisa e futi mikun e parë në shtrat. Nga ajo ditë, filloi t'i ndërronte partnerët. Nuk trembej nga asgjë dhe, me po atë lehtësi që u dorëzohej meshkujve, i flakte nga jeta e saj. Kush i afrohej asaj, rrezikonte shumë. Jo pak djemve u mbeti peng këputja e lidhjeve me Emën, gjithmonë sipas trilleve të saj, dhe filluan të trokasin ilegalisht nëpër dyert e psikiatërve për të marrë qetësues.

Ema e mori vesh shpejt, që ishte fëmijë e adoptuar. Që në zënkat e para me fëmijët e rrugës, ku banonte, atë e shanë "kopile", por kjo gjë nuk i bëri asnjëherë përshtypje. Shoqeve dhe shokëve të porsanjohur ua komunikonte këtë lajm e para me një barrë krenarie. Nuk u bë kurrë kureshtare të kërkonte babanë dhe nëse dëgjonte dikë, këta ishin prindërit e saj.

Kur mbaroi gjimnazin, prindërit e ndanë mendjen ta nisnin jashtë shtetit për studime. Atë kohë, ajo merrej me volejboll dhe ata shfrytëzuan një turne të skuadrës së saj në SHBA për ta nisur përfundimisht andej. I premtuan se do t'i shkonin shumë shpejt mbrapa, sapo të gjenin vizat e të shisnin shtëpinë, dhe ajo iku pa bërë zë. Në SHBA erdhi vërdallë nja një vit, duke menduar se për çfarë dege duhej të studionte, pastaj e ndau mendjen të studionte për financë dhe kështu bëri. Brenda tre vjetësh i përfundoi shkëlqyeshëm studimet universitare 5-vjeçare dhe menjëherë filloi punë në një bankë të Neë Jorkut. Nga dita e largimit, ajo nuk kërkoi kurrë dollarë nga prindërit. Pa punë kishte qenë, dollarë nuk kërkonte... Kaq duhej që Flora të profetizonte, duke thënë:

- Kush e di ç'pisllëk do të jetë duke bërë andej!...

I kishte rënë pikës! Një muaj pasi kishte shkelur në tokën e premtuar, Ema u afrua me një amerikan të kamur. E njohu krejt rastësisht, teksa shihte me kureshtje nga vitrina në rrugë bizhutë në një dyqan me emër. Tjetri iu afrua jo pa ndrojtje përbri dhe e ftoi të zgjidhte diçka në dyqan, meqë atë ditë kishte ditëlindjen. Ema pranoi menjëherë. I vuri gishtin një unaze me çmim astronomik, pastaj pranoi ftesën e të panjohurit për të darkuar së bashku, hëngri e piu atje sa iu veshën sytë dhe po atë natë e gdhinë në një hotel, në periferi të qytetit. I fali aq kënaqësi atë natë në shtrat, sa e bëri tjetrin t'i binte në gjunjë dhe e rropi pa pikë mëshire, aq sa mundi dhe pastaj, kur iu mërzit, e la pa e vrarë mendjen fare. E mbetur sërish vetëm, ajo vendosi të shohë një herë tamam rreth vetes se ç'bëhej e si jetohej në këtë botë. Pasi peshoi gjithçka, e gjykoi si më të mirën të ushtronte striptizën në një lokal mondan nate. Kur e bënte këtë punë një bullgare, shoqe e saj e dhomës, që më shumë ngjante me një zhapik sesa me një femër, si mos e bënte ajo që ua rrotullonte kokat meshkujve, si të qenë luledielli!

Sa e panë bosët e lokalit të parë, ku trokiti, e pranuan në çast dhe ylli i ri mblodhi sakaq rreth vetes aq fansa, teksa iu zhvishej para hundëve, sa nuk i dhembi më koka për të siguruar jetesën.

Me këtë punë u mor derisa përfundoi studimet universitare. Klientët ia mbushnin gjimbajtëset e holla e rripat e mbathjeve me dollarë dhe ajo, herahershëm, zgjidhte ndër më dorëlëshuarit për partnerë në shtrat. Për këtë gjë askush nuk kursehej, nëse ajo vendoste.

Lidhjet kalimtare, Emës i vinin për shtat dhe të ardhurat që fitonte, i siguruan një jetë më se komode. Sa për turp, as bëhej fjalë! Këtë ndjenjë Ema nuk e njihte!



Ditën që kaloi në Bankë, ajo e mbylli kapitullin e striptizmit. Asnjëherë nuk kishte qenë femër epshore, që vdiste po të mos bënte seks. Madje, lidhjet e shumta kalimtare e kishin bërë të humbiste kuriozitetin edhe ndaj hallateve të partnerëve!

Askush nuk mund të parashikonte se si do të rridhte jeta e saj, nëse nuk do t'i vdiste i ati nga një infarkt i papritur. Ema mori leje, prenotoi avionin më të parë dhe zbriti një natë të ftohtë dimri në Tiranë. Kur Flora e pa në derë, sa nuk pësoi fatin e të shoqit!

- Po ti ?! - thirri nën zë.

- Vetëm do të të lija?! - ia ktheu gjithë inat Ema, duke lëshuar valixhen në korridor.

Flora filloi të vëzhgonte me kujdes vajzën e saj marruke e yll të bukur dhe iu duk se më në fund ajo ishte shtruar. Tani nuk kishte ndonjë dëshirë të madhe të dilte e për t'u shoqëruar me meshkuj as bëhej fjalë. Por shtëpia po e mbyste. Atëherë vendosi të gjejë ndonjë punë, sa për të kaluar kohën, se për lek as bëhej fjalë të kishte nevojë.

Një mbrëmje, teksa pinte kafe me një shoqe në një verandë lokali, njohu rastësisht një mesoburrë te të 50-at me pamje fisnike. Ishte një i njohur i shoqes së saj dhe, kur Ema mori vesh se tjetri kërkonte një financiere të mirë për të drejtuar financat e kompanisë së tij, i shprehu dëshirën ta provonte një herë atë punë. Tjetri e pa gjithë dyshim. Kjo vajzë kaq seksi nuk dukej të kishte lindur për të punuar qoftë edhe një ditë të vetme. Por nuk ia prishi. Në fakt, ai nuk e dinte me kë kishte të bënte.

Nëse Ema mund ta kryente ashtu siç duhej detyrën, do të paguhej 300 dollarë në muaj, por një muaj më pas, kur Fredi, pronari i kompanisë, pa rregullin e vendosur menjëherë në financat e tij, e thirri në zyrë.

- Jam shumë i kënaqur nga ty, - i tha, - nëse dëshiron të lidhim kontratë bashkë, rrogën do ta kesh 600 dollarë në muaj!...

Emës i pëlqeu vlerësimi i tjetrit, siç i pëlqeu fakti, që ky njeri nuk do ta bezdiste me ato vështrimet epshore, të cilat ia prishnin humorin në çast.

- Dakord! - ia ktheu ajo, duke shtuar se duhej të njihej edhe me ligjet financiare të Shqipërisë, nëse Fredi nuk donte të kishte kokëçarje nga tatimorët.

Nga ajo ditë, Emës sikur iu mbush jeta. Ditën ajo merrej me pagesat e porositë e Fredit, kurse mbrëmjeve shfletonte Fletoret Zyrtare, duke parë ligjet në fuqi e duke u tallur me ligjvënësit anadollakë, që nuk kishin haber nga biznesi e evazioni fiskal. Dy muaj më pas, kur tatimorët do të trokisnin te zyrat e Fredit, sipas ritualit, për të bërë kontrollin rutinë, për t'u kapur diku e për të futur në xhepa ndonjë shuk me lekë, siç ishte bërë rrugë të ndodhte, Ema shkoi në zyrën e Fredit.

- Kanë ardhur tatimorët! - foli shkurt. - Ua dhashë të gjithë dokumentacionin që

Vijon në faqen 16

# NJË KUKULL QË NUK ËSHTË KUKULL

Vijon nga faqja 15

kërkuan, por ti nuk do t'u japësh asnjë lek! Puna e tyre është të kontrollojnë dhe të vendosin gjoba, po gjetën ndonjë parregullsi ligjore. Po gjetën gjë, gjobën e paguaj vetë, por atyre nuk do t'u japësh asnjë kokërr leku! Janë mësuar keq këta parazitë!...

Fredi nuk ia ndau sytë kësaj bishe të egër me pamje engjëlli. Nuk donte telashe e ishte gati të paguante sa të kërkonin, mirëpo as Emës nuk ia prishte dot.

- Ti e di këtë punë! - ia preu shkurt.

Një javë tatimorët derdhën djersë mbi letrat e kopsitura nga Ema, por nuk gjetën asgjë, përveç vështrimit ironik të kësaj femre të panjohur për ta, që dukej sikur thoshte nën zë: gërmo, Tare, gërmo, se varrin e qenit të ngordhur do të gjesh !...

Kur ata e kuptuan se nuk do të kapnin asnjë lek e se qenë rropatur kot gjithë ato ditë e po bëheshin gati t'ia mbathnin, ajo iu dha një këshillë me zë engjëllor:

- Mos hajdeni më kot këtu, se nuk do të gjeni kurrë shkelje ligjore! Po deshët ndonjë lek, investoni! Blini aksione te ne, sepse olimpike.

Ema e mori zarfin dhe, pa e hapur, e futi në çantën e dorës.

- Faleminderit! - tha pa ia ndarë sytë.

I pat lindur menjëherë dëshira ta fuste Fredin në shtratin e saj. Tani po e brente kurioziteti për këtë njeri me maskë.

Gjithë darkën, ajo e shtyu me këtë mendim dhe nuk e pati të vështirë ta tundonte tjetrin. Aq gjë e kishte mësuar përtej oqeanit.

Kur dolën, ajo ia futi krahun tjetrit dhe i pëshpëriti lehtë në vesh:

- Ku do të më çosh tani?

- Ku të duash!

- Ikim në Durrës! - tha ajo, duke shtuar se andej ka ca hotele të mira.

Nuk ishte e thënë të përfundonte deri në Durrës. Pa kaluar sheshin "Skënderbej", ajo propozoi të ktheheshin tek ish - "Vjosa". Tani i qe zgjuar gjaku i parë i padurimit dhe në të tilla raste nuk kishte Zot t'ia prishte!...

Në dhomë, ajo u përkujdes që Fredi mos ndihej keq, dhe, pasi mbaroi gjithçka e Fredi po bëhej gati të kotej, Ema tha ngadalë: jë tjetër, - ia ktheu ai. - Unë kërkoj nga të tjerët po atë respekt që iu jap! Nuk të kam trajtuar si shërbëtore dhe po këtë gjë duhet të bësh edhe ti, me mua!...

- Më fal! - mërmëriti Ema.

Sakaq kishte ikur.

Emën e fyeu sjellja e Fredit, por, në darkë vonë, teksa turfullonte me veten e saj, thellë-thellë, i dha të drejtë tjetrit. E kishte trajtuar si ndonjë mashkull të përvëluar pas saj, si ata jargashët, që psherëtinin lloj-lloj banalitetesh kur ajo kalonte në rrugë...

Të nesërmen, ajo trokiti sërish në zyrën e Fredit. Raportoi për punën e saj, pastaj, teksa po dilte, i kërkoi edhe një herë të falur tjetrit.

- U ndodha shumë bosh dje, por kjo nuk do të ndodhë më kurrë!...

- Kështu mund të bisedohet, - tha Fredi, - por jo me vendime të njëanshme. Si the atë natë? Ty nuk të pëlqenin iniciativat e njëanshme në këtë punë... Sonte, apo një ditë tjetër, mund të ma ofrosh atë darkën...

Atë natë përfunduan në Lezhë, në një hotel të drunjtë buzë detit.

- E di, - murmuriti ajo pas mesnate e jemi shoqëri aksionere!...

Të gjithë e shanë KURVË me vete, ndërkohë që Fredi u mbyll në zyrë. Nuk donte ta shihnin ata morracakë duke qeshur me këshillën e Emës të shqiptuar aq butësisht.

Atë mbrëmje Fredi e ftoi për darkë Emën. E njoftoi, se do të darkonin në restorantin më mondan të peshkut dhe se do ta priste atje në orën tetë të mbrëmjes. Kur ajo u shfaq në derë, klientëve iu ranë pirunët nga duart. Kishte veshur një fustan të kuq, të gjatë deri në fund të këmbëve, me një dekolte të thellë, që ia zbulonte gjoksin e mrekullueshëm.

- Ua zure bukën në fyt, - pëshpëriti Fredi, kur ajo iu ul pranë.

- As më kërcet për këta të palarë! - ia ktheu shpërfillshëm ajo, pa marrë mundimin të hedhë një herë sytë përreth. - Nuk është faji im që hanë akoma fasule me pilaf dhe mbajnë çitjanet si shenjë tradite!...

- Kaq e egër ke qenë gjithmonë? - e pyeti Fredi.

- Asnjëherë nuk kam qenë e egër! Konformizmin, po! Atë e urrej!

- Bëhu pak më realiste! Tani jeton në Shqipëri!...

- Se mos erdha nga qejfi këtu! Nga halli erdha! Kështu që nuk kam asnjë detyrim ndaj këtij realiteti! Kur të më teket, iki prapë! Nga kjo shoqëri, unë nuk kërkoj ndryshim. Atëherë pse duhet të kërkojë shoqëria shqiptare ndryshim prej meje?!...

- Bëj si të duash! - u dorëzua Fredi. - Unë të kam thirrur për darkë për tjetër gjë... Ti më ke bërë të mos kem më frikë nga tatimorët me punën tënde. Më ke kursyer kështu mbi 50000 dollarë, plus që tani unë nuk e gdhij syhapur nga frika e ndonjë denoncimi prej tyre. Këto para nuk mund të hyjnë të gjitha në xhepin tim. Mua më mjafton, që nuk kam më frikë!...

Ema e pa gjatë në sy tjetrin, pastaj filloi të buzëqeshë lehtas.

- Unë nuk fillova punë te ty ngaqë po vdisja për bukë. Por, edhe po na dhe ndonjë lek, nuk bën keq! Në këtë botë fiton ai që di të shpërblejë ndihmën!...

Shqiptoi krejt të kundërtën e asaj që po mendonte: të ngrihej e ta linte tjetrin si të dhjerë në tavolinë!

Ishte e bindur se edhe Fredi ishte me mendjen e saj, prandaj e habiti qetësia e tjetrit, kur futi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës, nxori që aty një zarf të trashë dhe ia vendosi ngadalë përpara.

- Janë të tuat! - shqiptoi me po atë qetësi



- Nuk desha lekë nga ty, por, i mora, sepse nuk kisha qejf të ta prishja!... Edhe diçka. Po deshe ta kalojmë mirë bashkë, mos e ço nëpër mend se jam prona jote dhe mos e merr kurrë iniciativën në marrëdhëniet tona private.

I ktheu shpinën e lakuriqtë tjetrit dhe sakaq fjeti.

Fredin e trembi akullsia e tonit të Emës. Ia kishte shqiptuar fare thatë e pa emocion mendimet e saj, ndërkohë që ajo nuk kishte asnjë ide, se çfarë shume përmbante zarfi në çantën e saj. E trembi edhe trilli i beftë i tjetrës për t'u kthyer në këtë hotel e për t'iu dhënë me një pasion të vërtetë, ndërkohë që deri para pak orësh nuk kishte ofruar asnjë shenjë për këtë bashkim.

E nesërmja i riktheu në pozitat e mëparshme. Ema dukej qartë që e kishte harruar ndodhinë e një nate më parë, ndërkohë që Fredi sepse pati një ide, që ajo po e vëzhgonte nga larg. Në këtë rutinë vazhduan marrëdhëniet e tyre, derisa një ditë Ema u rishfaq në zyrën e tij.

- Ke ndonjë plan për sonte? - e pyeti.

Mori një përgjigje mohuese nga Fredi.

- Hamë ndonjë darkë bashkë? Paguaj unë! - tha Ema.

Fredi e vëzhgoi gjatë.

- Pse më shikon?

- Më duket se më ngatërron me ndonstrukur në gjoksin e tij ku kishte filluar të ndihej mirë, - nuk të dua për seks, po për shok! Ti, më jep besim!... Nuk di si ta shpjegoj...

- E kam kuptuar këtë gjë, - ia ktheu ai.

- Nga e ke kuptuar?!

- Ti je një femër me bukuri të rrallë, je e rrethuar nga shumë meshkuj të rinj e me vlera, që do të shkrinin pasurinë të bëheshin të dashurit e tu, kurse ti më zgjodhe mua, krejt të kundërtën e tyre...

- Janë shumë provincialë, Fred! - tha Ema. - Ata nuk e kanë idenë se cila jam unë, çfarë kam parë e provuar, çfarë di... Ata mendojnë se unë jam një kukull budallaqe... Janë njerëz që paragjykojnë dhe ky paragjykim i ka fiksuar prej shekujsh në provincializëm!... Ti u solle që në fillim ndryshe me mua, megjithëse ishe i bindur se unë isha vetëm një lodër seksi. Ama, ti e munde vetveten, kur pranove ta provoje një herë të punonim bashkë...

- Më trego se çfarë ke parë! - iu lut befas ai.

Ema u mendua një hop, pastaj tha qetësisht:

- Lere, Fred! Mos na e prish sonte gjakun!

Po, tjetri nuk iu nda. Ishte vërtet kureshtar të mësonte se çfarë dinte kjo vajzë nga jeta, kjo vajzë e re e pa përvojë, e pamësuar me skamjen e me intrigat e këtij vendi...

**maj 2001**

# L
## LETËRSIA

NGA NATASHA XHELILI

Një natë boheme endet nëpër botë. Endet nëpër kohë,endet nëpër stinë, endet nëpër shpirtra të trazuar. Nëpër shtigje zemre, vishet me vetmi. Ngarkuar me terr e tmerr shkon udhë e paudhë. Sheh të djeshmen që qesh në qiell të lartë, ndërsa të sotmen e sundon si shkrumb rrënoje. E vesh me mjegull, shira e gjëmime. Midis të djeshmes e të sotmes ajo, nata, qëndron në mes. Digjet flakë prej dashurisë, ndërkohë që e sotmja vdes prej ikjes së Saj. Shkon në një mesditë që nuk i bindet, i verbohet bota brenda, po ia kthen përsëri sytë. Në kurmin e errët të udhës trillet e natës boheme përshkohen nga vargje të të gjitha llojeve, nga rima e strofa të shumëllojshme për të shfaqur në skenë "Shkreptimë e tjetër moti" e autorit Demir Gjergji.

### ARKITEKTURA E LIBRIT

Libri është ndërtuar në katër pjesë: Shkreptimë e shkruar, Shkreptimë e shkuar, Shkreptimë e shuar dhe Shkreptima+. Në secilën prej tyre përvijohen rrëfime lirike për pasionin, ndryshimin dhe për përjetime të larmishme që shfaqen si Carpe Diem, por që kanë rrënjët e një vullkani shpërthyes që do të jetojë gjatë. Grafullimi i gjithë ndjenjave si dallgë hyjnore pushton detin e fantazisë dhe sjell këtë libër që guxon të rreshtohet te poezia bashkëkohore shqiptare. Autorit i pëlqen të hulumtojë me fjalët, kjo duket te titujt e zgjedhur për secilën pjesë. Në secilën prej tyre hiqet nga një shkronjë, kjo jo për t'i sakatuar fjalët po për t'i ridimensionuar në një kuptim të ri. Këto gjetje prej poeti tregojnë punën e madhe të tij dhe intuitën poetike për të vendosur dykuptimësi në fjalë e vargje, gjë pa të cilën poezia nuk do të mbijetonte dot. Në tituj përkatësisht : e shk*r*uar, e sh*k*uar, e shuar. Brenda kësaj zgjedhjeje zhvillohet edhe përjetimi poetik që mbikëqyr gjendjet për t'i pasqyruar besnikërisht në këto vargje.

Shkreptimë: vetëtimë, shpërthim i menjëhershëm i diçkaje. Është ky shpjegimi i fjalës "shkreptimë" që Gjergji ka zgjedhur të transmetojë me anën e këtij libri me poezi. Në pjesën e parë i drejtohet muzës së vet "*Shkreptimë shpirti, shkruaj,/ ndrit me fjalë, rimë a theks/ ndizu larg në qiej të huaj/ në të tashmen time feks!*". Është diçka që ndodh shpejt, aq sa zgjat një vetëtimë, por është një kohë kur ndërrohet moti kur " *pa bujë, pa rite mortore/ la fronin e poshtë ra dimri"* dhe marsi duke e nderuar "*monarkun fisnik*", "*Zemërimin ia fsheh te blerimi dhe kristalet e borës , te lulet*". Kështu lind një stinë e re që mbart detaje të së vjetrës deri sa ta largojë plotësisht. Në këto momente autori mediton për vdekjen që e ndjek pas njeriun dhe e merr kur s'e pret. Pasi tregon marshimin e kohës me detaje të gjetura, duke u ndjekur nga transformimi i tyre " *fustani i bardhë mbi nuret e nuses,/ nxihet si reja e bardhë te muzgjet,/ plaga zë dregëz ngadalë dhe zhduket,/ hiri me hire dëshire po shkundet.*", ai tregon se ndryshe nga gjithçka vdekja nuk lë hapësira dyshimi " *shigjetë harrimi, në besë të pret*!"

Dualizmi brenda njeriut shfaqet herë pas here, sidomos kur ai ndihet keq dhe është gati t'i dorëzohet vdekjes. " *kur ndjehem keq/ dhe vetvetes këmbëzën jam gati t'ia heq...*" autori zbulon magjinë e jetës parë në sensin praktik. Duke i dhënë edhe nota humori vetvetja "zbulon" se kushton më lirë të jetosh sesa të vdesësh. Ka gjithmonë gjëra për të cilat ia vlen të jetosh, "*ajri është ende falas*", "*në ek-*

*Autorja bën një lexim tejet dashamirës të poezisë së Demir Gjergjit në përmbledhjen poetike "Shkreptimë e tjetër moti". "Sa e bukur është bota në sytë e një poeti! Sa dritë merr vargu nga të pathënat! E gjithë gjithësia ecën në majë të gishtave në çdo faqe të librit, në çdo hapësirë mes vargjesh, që priren të jenë të dashur për secilin lexues", shkruan ajo në shkrimin e vet.*



# Natë nomade me poetin Demir Gjergji

spozitën e prillit hyrja është e lirë", "mund të qeshësh sa të duash"; të gjitha elemente të rëndësishme për një jetë, por që kemi harruar t'i vlerësojmë. Një mesazh mjaft i rëndësishëm dhe aktual për të gjithë brezat, por më shumë pënë që jeton në një krizë vetëvlerësimi dhe pasigurie për të ardhmen. Vargjet e fundit janë një thirrje për të jetuar, për të zgjedhur gjithmonë jetën: *"kështu,/ sa herë ndjehem keq/ gishtin nga këmbëza Demiri ma heq."*

Herë Ajo (Ti) e herë një grua gjenden brenda diskursit poetik të këtij libri. Voluminoz jo vetëm për sasinë e faqeve apo hapësirave të pushtuara me tingujt e Shkreptimës, por edhe për larmishmërinë e gjendjeve shpirtërore që ndan me lexuesin, ky libër endet honeve të një burri që kërkon të shfaq gjithë kufijtë e vet të pamatshëm në lidhje me botën në sytë e tij, me dashurinë, me të shkuarën, të tashmen, të ardhmen, me historinë, gjithësinë, por më tepër me detaje që mund t'i rrok vetëm shpirti i në poeti. Në çdo poezi gurgullon vrulli i një vargu të latuar me kujdes. Jo vetëm fjalët, por edhe gjatësia e forma kanë një mesazh të caktuar . Ai krijon botë paralele dhe e mposht nocionin e kohës dhe hapësirës. Kapërcehen kufijtë e tyre dhe shkohet deri në grimcat më të vogla të pamatshme për të ndier emocionin e të qënit i dashuruar, i përjashtuar nga kjo ndjenjë, i braktisur a i rikthyer për t'u bërë pre i Shkreptimës. *" ende ka natë në shtrat"* është një pohim pararojë për vargun e Gjergjit, që rend pas çdo casti për të realizuar dhe plotësuar dashurinë e tij…

Pamja e një dite në sytë e saj ngjason me lirikat e natyrës e dashurisë së Lasgush Poradecit. Po kështu te poezia " Dy zjarre" rikthehet motivi i vetflijimit. Dy të dashur janë si dy zjarre që digjen nga dëshira për njëritjetrin. Bashkë janë më të fortë. Për t'u bashkuar duhet të lënë diçka nga vetja dhe gjithçka duhet të ndodhë për procesin e vetëkrijimit që kalon nga vetëflijimi.

Libri nuk është ndërtuar me poezi pa lidhje me njëra-tjetrën. Disa figura rikthehen për të treguar se ato (poezitë) janë pjesë e një korpusi të madh mendimi dhe në to gjallon një botë e tërë e ndërtuar me copëza(vargje) si në një mozaik të madh. Gjergji është nga autorët që mban gjallë figurën e aliteracionit *" e vjetër vjen vjeshta sivjet…" "trupi, peng në peshë të vet…" "shiu i fshiu shenjat e shkoi…"etj.*

Në pjesën e dytë të librit "Shkreptimë e shkuar" autori evokon kohë të kaluara që ende i sjell me zjarr brenda vetes. *"Shkreptimë e tjetër moti,/ mjegullash kërkon një shteg/ vjen më gjen si syrin loti,/ më keq se atëherë më djeg."* Megjithëse *" një trajtë krejt e zbehtë figure" " më shfaqesh si mëngjes i sotëm…"*, por mohimi i dikurshëm *" e shkulur gjer në rrënjë të fundit,/ prej frymës dhe prej trupit tim"* nuk ka më kthim. Ai nuk e kupton dot si ka evoluar jeta pa të: *" Si mbinte vallë ky bar në mars"*, por arrin në përfundimin se *"… prapëseprapë diku shtegton dashuria…"*.

Sa e bukur është bota në sytë e një poeti! Sa dritë merr vargu nga të pathënat! E gjithë gjithësia ecën në majë të gishtave në çdo faqe të librit, në çdo hapësirë mes vargjesh që priren të jenë të dashur për secilin lexues. Duhet thënë se ky libër mund të lexohet pa vështirësi vetëm nga një lexues i rafinuar i poezisë, por në shumësinë e krijimeve poetike, ku bëhet fjalë për poezi që trajtojnë një subjekt epiko-lirik mund të thjeshtëzohen dhe të kuptohen nga një masë më e madhe lexuesish.

Në pjesën e tretë: "Shkreptimë e shuar" duket se bota është zbrazur dhe trillet e



dashurisë kanë mbaruar. *"Shkreptima syrit shuhet…/ për gjëmimin kot mbaj vesh./ prapë pas natës bien muzgjet/ dhe pas muzgjesh çdo gjë hesht…"* kjo pjesë fillon me një përkushtim *"dole nga kjo shpellë e errët… ia besove qiellit jetën"* është një dhimbje e bukur për nga cilësimet që i bëhen një miku të dashur.

Edhe poeti jeton çaste si tokësor,- ishte mendimi që më erdhi pasi lexova disa nga poezitë e librit. Ai është i pajisur me një dhunti për ta parë botën ndryshe duke u bërë kronikan i kohës dhe i botëkuptimit të saj. Momentet kur zbret në tokë janë të vlefshme për ta njohur botën dhe t'u bërë pasqyrë e trilleve të saj. Ndonjëherë duke qenë i ndërgjegjshëm ai zbret në tokë dhe shijon të qenurit tokësor edhe pse e përshkruan këtë çast me nota humori e ironie.

Në pjesën e fundit "Shkreptima+" janë njëqind poezi të shkurtra, kryesisht me nga një strofë katërshe, po edhe të tjera, në përgjithësi me poezi meditues që shprehin një mendim të mprehtë mbi një çështje të caktuar. Shumë prej tyre janë shembuj të një mjeshtërie të ritmit, rimës e vargut të matur me gjatësi të ndryshme. Në këto poezi ka një dendësi figurash stilistike: *" Therin vendet e gjetheve të rëna!/ sëmbojnë sumbullat e sytheve të pritjes…/ kë të qetësojë më parë gjysmëhëna;/ vuajtjet e ikjes a dhimbjet e lindjes?!"*

**E HUAJA**

Ajo është një mister që kërkon të shpaloset te të gjithë burrat. Pak vargje, mbretëreshë metafora i vjen në ndihmë për ta realizuar në mënyrë të shkathët këtë poezi për gruan e titulluar "E juaja". *Korije e fshehur nën mjegull e gjethe,/në vajzëri./ pemë e rënduar frutash në pjekje,/ në nusëri./Mështekën e zhveshur rrënjëve e degëve,/ në vetmi!/ E j(h)uaja,/ gruaja!* Sa shumë thuhet me pak fjalë! Një botë e tërë që shpaloset me gjelbërimin dendësinë e egërsinë, me frutat në pjekje, me rrënjët e dala e degët e zhveshura. Kalohet gradualisht nga delikatesa te forca, nga dlirësia te mbijetesa, nga e shkuara te e ardhmja, sepse gruaja është ajo që mbetet e huaj për botën(burrin), që gjunjëzon, por nuk çmitizon paragjykimet për të.

Njeriu është një qënie e vetmuar në këtë botë. Ai kërkon të plotësohet dhe për këtë gjë lufton tërë jetën. Duke u nisur nga tema biblike, aventurore poeti kalon te vetja për të treguar vetminë e madhe. Nisur nga Krishti : *" jam fillikat përmbi Golgotë"* kalohet te Odiseu : *"i humbur në vetmi-liri"* duke bërë paralele me veten: *"pa asnjë hije bime pranë"* dhe atë : *" e vetme ndihem nëpër turmë"*, ai rrek të tregojë se sa e vështirë është: *"që s'po ta gjej gjëkund një gjurmë"*.

Besimi te dashuria e vërtetë ndryshon konceptin për botën dhe krijimin e saj. Tashmë dy qënie njerëzore veprojnë si një e vetme: *" nga puthja jote po marr frymë"*. Ai ka krijuar himnin e vet të bukurisë që mund të rreshtohet përkrah çdo poezie tjetër të këtij lloji qoftë në poezinë shqipe, qoftë në atë botërore:

Strofa: Fshihu, bukuri, se m'i more sytë!/ eja, kur për veten s'do të kem më nge!/ Atëbotë në mua, mbilli plagët, yjtë,/ të më zgjosh me hiret, thellë kur të fle!

*Antistrofa: Shfaqu bukuri, të m'i sjellësh sytë!/të jetë ç'të jetë, ndodhtë këtë jetë!/ fiki nëpër mua, plagët edhe yjtë,/ të ndizemi bashkë në Flakën e Shenjtë!*

Nëse dashuria kalon në shumë ankthe, dyshime, përjetime, mund të bëhesh rob i saj. Përkundrejt këtij pasioni që jetohet deri në fund shfaqet njeriu i lirë në gjirin e natyrës që jeton pa luks, po me një qetësi për ta pasur zili. *"I mjafton një hije/ për ta pasur strehë/ gjelbëro korije!"*

E gjithë jeta është një kërkim, një gjueti. Gjueti për punë, për të ardhura, për një të dashur, për një vend magjik për të jetuar, prandaj burri është një *" hark shigjete"* e gruaja *"drenushë në ndjekje"*. Është një ndjekje që nuk mbaron. Ajo duke kërkuar gjithmonë shtigje të reja shpëtimi se ka frikë nga e panjohura dhe harku i shigjetës duke u përpjekur të godas përherë në zemër, jo për ta vrarë, po për ta zbutur këtë qenie të bukur e të përsosur për të cilën ka nevojë. *"Heshta ty të ndjek/ tek unë plaga djeg"* ("Vetëtin"f.16)

**DUELI**

Rikthimi është një ndjenjë e bukur. Përballja me veten, përmbledhja e jetës, ndodhin atë çast në pragun e fëmijërisë. Ndjesia e të qenit i plotë e mbush këtë moment solemn ku ndihesh fjalëpak dhe je gati të shpalosësh me krenari aventurën tënde. Janë dy detaje që mbushin pafjalësinë: nëna dhe pragu. Ndeshja me ta është e vështirë, atyre je gati t'u japësh gjithçka që të kanë dhënë. Por a kemi mundësi që të japim aq shumë sa kemi marrë prej tyre? A mund t'ia kthejmë nënës aq dashuri, përkëdhelje e pragut aq ngrohtësi e siguri?

Rendja nga simbolizmi te modernia nga klasikja te tradicionalja nuk e shkëput dot poetin edhe nga folklori kur shfaq idenë e vazhdimësisë nëpërmjet drurëve të mbjellë mbi varret e dy të dashurve. Dënimi për dashurinë e paragjykimet për të vazhdojnë të vrasin në realitetin shqiptar. Ndoshta prandaj kërkohet një vend ideal për të jetuar larg kufizimeve e rutinës së përditshme. Poeti u referohet shpesh vargjeve popullore, si një burim i përhershëm frymëzimi dhe nostalgjie, duke zbuluar aty gjithmonë një këndvështrim të ri, duke shtuar syresh të reja: *" bëri mirë që ra kjo mjegull/dhe e la pa sy mëngjesin…"*

Në çdo kohë ndodhin ndeshje mes të kundërtave. Depërtimi deri në thellësi të padukshme lind ndeshjet e pashmangshme. Pranëvënia e antitezave i mëshon faktit se ndeshjet ndodhin, pavarësisht vullnetit tonë për t'i kryer apo jo. Dueli çon përpara botën tonë të të kundërtave.

Procesi i krijimit është një botë e tërë. Përkthimi duket se zgjon një ndjesi të çuditshme te poeti. Ai e krahason atë me një vajzë që si nuse është nisur për larg. Për së pari ai nuk e njeh poezinë e vet të përkthyer në një gjuhë tjetër: *" në një tjetër gjuhë si në tjetër trup"*. Ai thekson faktin se përkthimi, edhe pse është i nevojshëm për t'u lexuar poezitë në gjuhë të tjera, është një proces shndërrimi, ridimensionimi dhe shtegtimi. Kjo poezi e përkthyer me *" të tjera zanore, në të tjera rima"* duhet të përballet me botën e vetme për të mbijetuar.

Nasho Jorgaqi është shprehur: "Në përfytyrimin tim poezia lirike shqipe gjithnjë i ka përngjarë një orkestre e cila ka përftuar muzikë të shpirtit e të botës shqiptare." Demir Gjergji, duke qenë një nga përfaqësuesit e poezisë lirike bashkëkohore shqiptare e përmbush më së miri këtë tipar të poezisë shqipe.

Nata boheme thërret në gji të saj gjithçka të poetit. Në shtegtimin e gjallë, në një fundgusht, ai merr me vete gjithë botën e tij. Në të ecin bijtë me lejen e Zotit, ecin gjithë ëndrrat që ka parë në jetë, ecin heronjtë që trimërojnë shtigjet, ecin të vdekurit që rrinë me të gjallët, ecën gjithësia si një personazh, me qiej e yje, me diell e hënë të plotë, ecin të gjithë vargjet me rima e strofa. Bashkë me poetin një krijesë e brishtë që e drejton "botën". Nata boheme zgjat sa një pafundësi. Aty në terr të zi shtegtarët gjejnë veten. Dorëzohen në pranga dashurie, kryejnë ritin si të parët që shkuan në hënë, lënë pas re e mjegull dhe zgjohen në krahët e mëngjesit të rilindur.

***Delvinë më 22.09. 2018.***

P
POEMA

*Autori sjell një poemë klasike, por zgjidhur me figuracion modern. Nota ekzistenciale shihen tashmë në veprën e autorit klasik të poezisë shqiptare...*

# ÇARTJE



NGA FASLLI HALITI

Brenda vetes
Kam inat,
Tritol
Inati im
Ç'inat egërsire është kështu
ky, inati im?

Tritolininatin e çova në gurore për shpërthim.

***
Brenda vetes
Kam amebën e smirës,
Me gjemba që shpon shpirtra,
Smira ime
Uthulla,
Acidi
Që gërryen dhe ha enën e kuqe të zemrës.
U shpua zemra ime, kupa e bakërt.
***
Plasën venat, kapilarët periferikë.
Gjaku mori trupin.
Nuk qarkullon,
Derdhet
Nën lëkurë.
Nuk e ushqen më trurin,
Përmbyt...
Truri
I përmbytur
Prodhon figura çudane.
Lemeri figurash gaforre,
Konfiguracione shtrembëse.
***
Tru!
Eja në vete
Ç'bën kështu?
S'ta duroj deformimin prindërve.
Pse ma deformon, ma bën hardhucë nënën?
Pse ma bën dinozaur babanë?

Tru!
T'i hodha trutë në erë!
Ç'bën kështu?
***
Sy të shqyer,
Të zgurdulluar,
Sferikë.
Rrokullisen sytë,
Rrokullisen kokërdhokët.
Sy që rrotullohen si sy kameleonësh,
Që shohin para
Mbrapa.
Hundë
Të zmadhuara,
Shtrembëse
Hundë të zvogëluara.

Pinoku
Me hundë fasule,
Sokrati me hundë Pinoku,
Pinoku filozofon shkurt,
Sokrati spiritoz në aeropag,
Ofelia
Me mjekër bionde.
Otello bën dashuri të deformuar me Ofelinë,
Hamleti puth me buzë të deformuara arapi
Desdemonën,
Shelgu i zi
Dridhet nën ujin e gjelbër të pellgut,
Si një Otello gjithë xhelozi.
***
Hamleti
Pusht filozof.
Hamleti, Don Zhuan,
Teatral, marrok...
Otello
Xheloz?
Xhelozi nuk vret, nuk mbyt...
Xhelozi pret rivalin të vdesë,
Otello
Faqeziu, xhelozi, i pabesë !

Puthu Desdemonë!
S'bën pabesi,
Nuk aventuron.
Ti bën dashuri,
Dashuron.

Puthu Desdemonën nën shelgun e zi kësaj mbrëmje!
Marrëzi e shtirur, fiktive, hamletiane!
***
Otello
Tragjik
Në xhelozi
Puthu Desdemonë!
Puthu, ti puthu, Ofeli!
***
Tru
Të derdhur,
Si vezë bretkosash plot larva të zeza,
Që pluskojnë në ujërat pranverore.
Vezë laraskash
Në tru.
I dëgjoni çukitjet?,
Apo s'i dëgjoni, ju ?

Zogu laraman i laraskës sqepon lëvozhgat në tru.

Tru!
Qenke pa tru!
Krisi korja e hemisferave,
Po të futet marrëzia nëpër krisat, të çarat kështu?

Qelqi i syrit plot arabeska.
***
Gjak!
Ti s'paske gjak!
Pushoje përmbytjen e trurit.
Ushqeje, të paktën, trurin pak...
Mençuria fishket.
Thahet
Pa ty zoti gjak...!
***
Po ti mençuri, ku e ke mençurinë?
S'ka mençuri
Pa tru,
Nga celulat e trurit vërshuan larva bretkosash.
Kuakje në trurin e bërë pellg, kënetë,.
Kor zarigogash në fluturim,
Përfytyrime çudane.
Shtrembëse,
Si kulla e Pizës
Imazhesh si gaforre,
Mençuri idiote, gallofe...
***
Kush e ka fajin?
Zemra e shpuar?
Kush të shpoi
Ty,
Zemër ?
Inati im i sertë?
E kuptova...
E shpove ti,
Smira ime uthull, acid?
Pa zemër paske qenë, moj smirë, e zezë, zi!
***
Unë
Strehoja urrejtje dhe smirë?
Vetja ime
Strehonte çaste urrejtjesh,
Bankete inatesh dhe smire?!
Qenke krijuese mizorish, moj. vetja ime?
Qenkam një zero atëherë dhe unë.
Zero
Me bisht!
Ku e ka bishtin zeroja?
Ç'u bë?
Ia prenë
Apo ia fshehën tinëzisht?

Kurse
Ti
Njësh,
Je biznesmen, je bos.
Duke qëndruar para zerove
Ti bën me to miliona, miliarda..., bën një kaos...
***
Çudira zerosh!
Zerot
Bëjnë çudira,
Zerot ndërtojnë vila,
Vila
Për 1,
Për 2, për 3 ...

Njëshi-
Bosi
Çifçiu
Më i madh,
Dyshi, treshi, katra, pesa...
Bosët, çifçinjtë më të vegjël,
Vrapues që ia marrin cilitdo atleti në kthesa...
***
Për njëshin,
Për dyshin,
Për treshin...,
Parajsa - një shkretëtirë, një Saharë.
Diku. gjetkë, kullosin, harbojnë ata...
I bien Botës kryq e tërthor.
Udhëtojnë
Mbi kurrize zerosh,
Siç e kanë zakon të na cilësojnë,
Domethënë mbi kurrizet tona,
Mbi kurrizet e taksapaguesve, domethënë,
Në tavolina Zeuzësh ambrozion shijojnë...

Ne ''zerot'' mbushim tavolinat e Zeusve
Me të gjitha të mirat e kësaj toke !
Për vete hamë thërrimet,
Lëpijmë kockat,
Hamë mbeturinat
E kësaj
Bote .. .
***
«Ju zerot, skelet!,
Ju zerot-
Kockë e lëkurë ?
Propagandë komuniste!
Sot, zerot më rrumbullake se kurrë...!»

Ekipi i 1, 2, 3,
Luan bilardo,
Bixhoz,
Luan me zare
Nëpër kazino vendi,
Kazino ballkanike,
Europiane
Zerot duartrokasin.
Njëshi ka shumë fansa,
Ka tifozëri të madhe.
Të tjerët pak tifozë dhe shumë klakerë.
Sa harxhon klani i 1, 2, 3...?
Më shumë se bunkerët,
Më shumë se tunelet?
Sa harxhojnë ''zerot'' së bashku,
Sa kanë harxhuar bunkerët?
***

Brenda meje
Indinjata,
Urrejtja, protesta, përgjojnë në pritë,
Rrinë në pozicion ofensive, beteje...

Urre,
Urre,
Urre, urrejtja ime e urryer!
Protesto,
Protesto
Protesta ime pa pikë proteste!

S'po më ndahesh nga gjoksi moj urrejtje.
S'e kupton vërtet që unë s'të dua?
Unë plaku
Ti rinohu...
***
Më urrejnë dhe mua!

Zelli im po kalbet,
Vullneti im po bëhet skelet,

## ...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri mund ta paramendohet se ishte disi më e mirë se një numër më parë. Kishte dy tema kryesore. Njëra na u ofrua nga Gent Çoçoli që kishte zhvilluar një intervistë me Arion Hysenbegas, lidhur me romanin e parë shqiptar fantastiko-shkencor. Autori jeton jashtë vendit dhe duhet thënë se në botimin e tij të parë është pritur shumë mirë nga publiku, por duket pak si e ekzagjeruar kur thuhet...deri me entuziazëm nga ai. Të mendosh sesa lexon ky publik e kupton përcaktimin. Prisnim që autori të ishte pak më i plotë sa i përket eksperiencës së tij letrare. Genti kish punuar me kujdesin e vet dhe u treguar shumë korrekt...

Në kujtim të Rinush Idrizit, Fatos Kola na kish sjellë një shkrim të gjatë dhe disi patetik, duke e ngritur në piedestal kritikun e ndjerë që duhet thënë se realisht u dallua. *Ai shpërtheu në kritikën letrare të kohës me kompetencën, inteligjencën dhe pjekurinë e një njohësi, vëzhguesi dhe vlerësuesi të ditur e të drejtë. Përbuzte klishetë dhe kiçet në krijimtarinë letrare, pasoja këto të konformizmit, mungesës së kulturës, shabllonizmit shpërblyes të mediokritetit dhe varfërisë metodologjike të zhdanovizmit të imponuar*. Kur dëgjon këto fjalë, mendon sesi ka mbijetuar në atë kohë, paçka se duhet thënë që punimet e tij janë shumë të mira.

Redaktori shtoi një shkrim për Komunizmin që sipas tij po kthehet në një gjë për të përfituar. *"Në kohën tonë është rikthyer ose më saktë rikthehet komunizmi sa herë që politika do të shmangë vëmendjen nga problemet e saj. Është e vërtetë që një iniciativë përpiqet që të vendosë një lloj rregulli në përballjen e filmave dhe librave, por që megjithë përpjekjen vazhdimisht bllokohet prej futjes së lloj-lloj mendimeve dhe konfrontimeve. Në fakt, është e habitshme sesi sot ende jepen mirëfilli materiale propagandistike të së shkuarës, që më shumë sesa glorifikim i asaj kohe i përshfaq absurd në qëllimet e tyre njësitë emetuese ose botuese"*, shkroi ai, por që në fakt duhej të ishte shumë më i hapur. U tregua më shumë sesa i kujdesshëm, fakt, që nuk duhet vlerësuar aq shumë.

Daut Gumeni solli një cikël që përmbledh ndjenja nga melankolia, por edhe kujtimet e trishta të tij të dënimit dhe mbi të gjitha shndërrimin e njeriut të ri shqiptar...Autori është sa i këndshëm dhe i qetë në poezitë që e lidhin me traditën, por edhe aq i rreptë me ata që e lidhin me ditët tona. Forma e poezisë, që kish zgjedhur, mbetej shumë e thjeshtë dhe me shumë taban foklorik

Tema e dytë kryesore ishte e Qerim Vrionit, i cili solli shkrimin më të ndjerë, sa i përket një fotografi nga Jugu i vendit. Jorgo Vaso nga fshati Sotirë i Dropullit të Sipërm ishte një fotograf që vinte nga minoriteti grek dhe me thjeshtësinë e punës dhe aftësinë për të dokumentuar la një trashëgimi të mirë për kohën. Struktura e Vrionit ishte shumë klasike. Kurse Preng Maca solli një tregim, që duhet thënë se nuk ishte punuar si duhet...Numri ishte relativisht i mirë dhe i qetë, por jo shumë mirë i punuar nga layout, që gjithsesi e zgjidhi në kohën e duhur.

Shpatullat po dembelosen çdo ditë,
Duart e mia të thara,
Përtace,
S'po lajnë dot njëra-tjetrën,
Pa le pastaj të lajnë fytyrën.
Dembelia
Placentë urrejtjeje, smire, zilie, inati.
***
U prishe vullneti im...

Vullnet pa vullnet,
Vullnet pleh,
Me kë t'i kapërcej pengesat?
Ku t'i gjej përpjekjet volitive?
Karakter!
Unë
Mburrem me ty,
Pse tregohesh pa karakter
Vullneti im,
Unë mburresha me ty.
Më dole pa vullnet
Dhe ti.

Mençuri marroke,
Budallaqe mençuri.
Po të flak nga deriçka e trurit dhe ty.
***
Plasën sytë.
S'i shoh hardhucat,
Akrepat,
Gaforret e përfytyrimeve në sy.
Uji qelqor i syve u derdh.
Përmbyti mjedisin:
Sferat e syve u rrokullisën.
Drita e syve doli si rrufe sferike nga sytë.
Rrufeja sferike e syve zgjon.
Nuk vret,
Përkëdhel,
Nuk trondit.
***
Mbete
Vetëm,
Zonja inteligjencë.
Të humbi mençuria.
Erudicioni,
Kultura.
Nisi stina e vjeshtës.
Kultura, erudicioni, mençuria-
Gjethe të verdha vjeshte,
Shkundur nga stuhia.

E para u këput gjethja e mençurisë,
Ra në moçal si këmbë pate;
E dyta ra gjethja e kulturës,
Noton në pellg me rosat;
E treta u këput gjethja erudite.
Ra në llucë.
Mbeti
Trungu im
Me degë të zhveshura.
Era dredh degët me forcë.

Degët dredhin trungun gjer në tokë.
***
Trungu im plot miza.
Mizat hanë kalbësirën trungore.
Po përparon kalbësira...
Rrufetë frikësojnë frikën.
Vetëtimat i përcëllojnë vetullat trimërisë .
Trimëria me vetulla të përcëlluara ikën dhe ikën.
***
Trimëri
Futi krahun frikës.
Jepi dorën!
Vetëtimë bandite me shtiza flake.
Rrugë kriminale me krisma:
Rrufe pa humanizëm, kulturë.
Vetëtima injorante!
Përvëloni majat e lisave.
Kurseni shkurret dhe kaçubet me përkulje galante.

Bubulloni bubullima budallaqe,
Servile të vetëtimave!
Stuhi
Me flokët gaforre.
Dallgë
Në panik!
Sulmojnë
Apo ikin të thyera
Dallgët me vrap?
Në shekuj ato sulmojnë brigjet,
Dhe brenda brigjeve mbeten prapë?
***

Po ai shkëmb pse qan?

Është Niobea që qan?
Le të pëlcasë së qari mburravecja!
Sfidohet perëndesha Latonë?
Ç'iu desh Niobesë të sfidonte perëndeshën.
Humbi fëmijët sfidantja mitike për pak sfidë.
Edhe ti perëndesha Latonë,
Nerone paske qenë...
Vriten gjashtë vajza.
Vriten shtatë djem?

Edhe vajzën që i le gjallë qyqes Niobe
Dyllë të verdhë ia bëre, ia le,
Frika që i kalle
E zverdhi
Atë...
***
Brenda meje,
Dashuria.
Një Dashuri
E padashura ime,
Si s'më deshe, moj dashuri
Si s'më dashurove kurrë
Dhe kë mua,
Që marrëzisht desha
Dh •mendurisht të dua!
U shtire ti
Apo unë
U shtira me ty?

S'të desha unë?
Po
Më akuzon?
Më duaj më mirë
Më dashuro më mirë
Moj dashuria ime e dashur, dashuromë!
***
Ju veshët e mi pa timpan jeni kështu,
I dëgjoni apo s'i dëgjoni uturimat.
Gjëmimet,
Bubullimat?
***
Po ju sy
Pa bebëza jeni,
Ç' bëhet rreth e rrotull
Shikoni apo nuk e shikoni
Ju dhëmbë pa nervë,
Ju pret nxirja!
Si,
S' më besoni?!
***
Gjuha shkretëtirë, me kokrriza rëre.
Me fjalë të zhuritura,
Të thata
Si rërë Sahare!
Fjalë lakuriqe shtrirë mbi rërën e gjuhës,
Mendimet kërrusen në tru.
Ka mendime pa fjalë?
Pyet memecët!



M'u tha gjuha për një syth fjale,
M'u tha fjala për një lule mendimi,
M'u thanë mendimet për idera të reja.
Idetë
I mori uria
Për pak filozofi.
Mjerë memecët:
Kanë etje,
Kanë uri
Për një fjalë...
Ej, memecëria ime, memecëri!
***
Po filozofia
Pse më duhet?
Hahet si buka?
Pihet si uji?
I merret erë si lules,
Vishet si xhaketë,
Si pallto në stinën dimërore?
Mbathet si këpucët?
Vishet si shall
Në kohëra
Dëbore,
Mbjell, korr, shin, gatuan, ajo vallë?

Filozofia
Një
Xhungël.
Më trembin tigrat, luanët,
Më helmojnë kobrat,
Më tallin majmunët,
Më përqeshin papagajtë:
Më çjerrin macet e egra e xhunglës së saj.

***
Brenda vetes
Kam
Jetë
Dhe
Vdekje.
Pa jetë s'ka vdekje...
Vdekja
Është
Skifteri,
Ujku, luani.
Jeta është zogu, kaprollja, fazani, dreri...!
***
Ka
Zogj
Pa skifterë?
Ka skifterë pa zogj?
Ka drerë pa luanë?
Ka luanë pa drerë?

***
Flaka
I duhet drurit,
Apo druri, flakës?
Shuhet
Flaka
Apo digjet druri?

Po zjarrin kush na e solli, kush na e pruri?
***
Kur s'ka korrent,
Na rri varur xixëllonja si llambë vajguri,
Kur jeta bëhet e përjetshme.
Vdekja
Bëhet e vdekshme.
Lamtumirë moj vdekje e vdekshme!

Përshëndetje ty jetë e përjetshme...!

*1991-2017*

H
HISTORI

*Një koleg që jep lëndën e Historisë së Rusisë në Islandë i ka folur autorit rreth vizitës së Hrushovit në Shqipëri. Madje ai i ka rrëfyer dhe një dhuratë që Hrushovi ka marrë nga Enver Hoxha. Kjo dhuratë ishte një kostum tradicional shqiptar i veshur nga Preng Bib Doda...*

# Napoleoni III, Preng Bib Doda, dhe një muze i munguar

NGA: NDREK GJINI*

Napoleoni i III (1808 – 1873) ka qenë kum bari i Preng Bib Dodës. Këtë fakt e mësova veç disa muaj më parë. Një kolegu im, lektor i lëndës së Gjenealogjisë në Univeristetin Kombëtar të Irlandës në Galway, në pushimin mes seancave të një konference kushtuar Napoleonit të III më tha; - A ka në Shqipëri një muze kushtuar Bib Dodës?

Nuk jam i sigurt, - i thashë – por nuk besoj të ketë.

Atë mbrëmje, pas konferencës u takuam serish. Ai më foli gjatë dhe gjithë pasion rreth historisë së Bib Dodës dhe faktit se si Napoleoni i III u bë kumbari i djalit të vetëm të tij, Prengës. Napoleoni i dhuroj atij edhe një prej shpatave të tij; shpatë me te cilën i biri, Prenga ka pozuar me krenari në disa foto të tij, i veshur me kostumin kombëtar shqiptar.

Në ditët në vijim nisa të gërmoj në biblotekën e Universitetit dhe në internet për të gjetur diçka më shumë rreth këtyre fakteve. Punët e ngjeshura të përditshmërisë time ma bënë ta lë pas dore këtë kërkim.

Por fatmirësisht krejt papritur një tjetër koleg që jep lëndën e Historisë së Rusisë, më flet disa jave me vone, rreth vizitës së Hrushovit në Shqipëri. Madje ai më tregon edhe për një pemë që Hrushovi ka mbjelle në kryeqytetin shqiptar, dhe një dhuratë që Hrushovi ka marrë nga Enver Hoxha. Kjo dhuratë ishte një kostum tradicional shqiptar i veshur nga Preng Bib Doda.

*Preng Bib Doda, ka qenë Princi i Mirditës. Ai lindi në Orosh të Mirditës në vitin 1858 në familjen e Gjomarkajve. Gjomarkajt ishte autoriteti me i larte i pleqërimit të kodit zakonor shqiptar(kanunit) në Gegëri dhe prijësit tradicional të Mirditës.*

*Ai ishte një ndër drejtuesit kryesor të Lidhjes Shqiptare te Prizrenit. Komandant i Lidhjes se Shkodrës dhe komandant i forcave Mirditore e Shkodrane që luftuan në mbrojtjen e Hotit e Grudës nga malazezet ne vitin 1880.*

*Kandidat për fronin mbretëror të Shqipërisë në vitin 1914, dy here zëvendëskryeministër dhe dy here minister. Nder figurat me te shquara te kombit shqiptar, me një kontribut te jashtzakonshem ne drejtimin e kryengritjeve për liri e pavarësi! U vra me 22 mars ne vitin 1919 ne Zejmen të Malësisë së Lezhës. Pas vrasjes së Preng Bib Dodës, për një periudhë të shkurtër Mirdita u drejtua nga e shoqja, Luçia. Më pas, parinë e Mirditës e mori kapedan Marka Gjoni, po nga familja e Gjomarkajve.*

Keto fakte nuk kane ndonjë peshe apo rendesi te veçantë në historinë e një vendi. Por, nese ne do t'i perdornim këto muze (te munguara, vende, madje dhe peme, për nxitjen e industrise se turizmit, ato do te luanin nje rol jo te vogel ne thithjen e turisteve të kulturës dhe historise; turiste të cilët këto vitet e fundit jane kthyer ne trend ne gjithe boten.

Do ishin me dhjetra mijera turiste franceze qe do ta vizitonin këtë muze (te munguar) te Bib Dodës. Dhe, po aq, ne mos me shumë rusë, që do vizitonin këtë peme, (ndofta tani e prere per t'i lëshuar vendin ndonjë pallati shumekatesh ndertuar vitet e fundit, apo ndonjë objekti tjeter).

### Preng Bib Doda

Preng Bib Doda, ka qenë Princi i Mirditës. Ai lindi në Orosh të Mirditës në vitin 1858 në familjen e Gjomarkajve. Gjomarkajt ishte autoriteti me i larte i pleqërimit të kodit zakonor shqiptar(kanunit) në Gegëri dhe prijësit tradicional të Mirditës.


Preng Bib Doda

### Veprimtaria

Ai ishte një ndër drejtuesit kryesor të Lidhjes Shqiptare te Prizrenit. Komandant i Lidhjes se Shkodrës dhe komandant i forcave Mirditore e Shkodrane që luftuan në mbrojtjen e Hotit e Grudës nga malazezet ne vitin 1880.

## Pse e shkruajta këtë histori

Keto shenime te shkru ara nxitimthi ne laptopin tim muaj me pare do kishin fjetur aty gjate, ose mund te kisihn humbur krejt pas disa viteve, kur ky loptop do ishte prishur, po te mos ma nxsite kureshtjen rreth kesaj teme nje shkrim brilant i mikut tim nga Kosova, Profesor Nexhmedin Spahiu.

*Ja cfare shkruan ai nder te tjera ne shkrimin e tij te botuar para pak diteve:*

### KATOLIKET E MIRDITES ME S ULLTAN MURATIN I KUNDËR PRINCIT LLAZAR

*Kur me 28.06.1389 u zhvillua Beteja e Kosoves, shqiptaret u rreshtuan ne te dy palet kundërshtare. Derisa Balshajt moren pjese ne anen e princit Lazar Hrebljanoviq, mirditoret – me kapedanin e tyre – u rreshtuan ne krahun e Sulltan*


Lucia e shoqja e Preng Bib Dodës

*Muratit I. Meqe osmanet e fituan luften, per kete mirditoreve iu garantua autonomia, të cilën e gëzuan deri ne shekullin XIX. Mirditoret nuk paguan fare taksa dhe qeveriseshin me kanunin e maleve, ndersa i vetmi detyrim i tyre ndaj sulltanit ishte qe te shkonin ne lufte kurdo qe te kishte nevoje sulltani, me ç'rast u takonte plaçka e luftes.*

### BIB DODA DHE LUFTA E KRIMESE

*Rasti me i njohur i pjesëmarrjes se mirditoreve në luftërat osmane ishte Lufta e Krimese (1853-1856) kur roli i ketyre 5.000 luftëtarëve ne krye me kapedanin Bib Doda (1820-1866) ishte vendimtar për fatet e betejës kryesore.*

*Ashtu si e shpjegon romancieri i pare shqiptar, Dom Ndoc Nikaj (1865-1951), qe ishte i biri Gjoke Jake Nikajt, njerit prej ketyre luftetareve te Bib Dodes, kur ushtrite osmane, angleze e franceze ishin duke u mundur nga ushtria ruse ne betejen kryesore, mirditoret – duke mos përfillur qofte me te voglin rregull ushtarak, duke rrezikuar jeterat e tyre ne maksimum – i shkaktuan habi ushtrise ruse dhe e thyen ate. Per rrjedhoje, Sulltan Abdylmexhiti I (sundoi ne përiudhën 1839-1861) i dha Bib Dodes titullin Pashe, ndersa Perandori i Frances, Napoleoni III (sundoi ne periudhën 1852-1870) u be kumbar i djalit te vetem te Bib Dodes, Prenkut (1860-1919).*

Opinioni i Ditës

# Roli i Enver Hoxhës për Kosovën dhe çështjen kombëtare

Nga Blerim Latifi

*(vijon nga faqja 1)*

...në ish-Jugosllavi që ushqejnë një simpati e vlerësim ndaj Enver Hoxhës dhe regjimit të tij. Ekzistenca e kësaj nostalgjie për enverizmin mund të ishte e kuptueshme deri në vitet 90-të kur shqiptarët jashtë kufirit ishin të tejngopur për dekada me radhë nga propaganda shurdhuese e sistemit totalitar që kishte ndërtuar kultin e individit udhëheqës. Kuptohet që për shumë shqiptarë gjatë okupimit sllav bëhej fjalë ose për t'u orientuar nga Beogradi i robërisë ose nga Tirana, pavarësisht se kush e sundonte Shqipërinë. Mirëpo tani që po mbushen dy dekada nga çlirimi i Kosovës dhe shqiptarët janë të lidhur e komunikojnë me njëri tjetrin si asnjëherë më parë, është e pakuptueshme dhe indinjuese që ka ende nga ata që besojnë se Enveri dhe regjimi komunist ka qenë i dobishëm për Shqipërinë dhe kauzën kombëtare.

Pikësëpari, kur flitet për rolin historik të Enver Hoxhës dhe regjimit që ai drejtoi, nevojitet një reflektim dhe ndryshim opinionin për komunizmin për faktin se regjimet e mbështetura tek kjo ideologji kanë bërë krime nga më mizoret duke eliminuar mbi 100 milionë qytetarë të pafajshëm. Mjafton të shikohen tmerret e periudhës së terrorit të kuq, spastrimeve dhe holomodorit në Bashkim Sovjetik, hopi i madh përpara dhe revolucioni kulturor në Kinë apo vrasjet masive të khmerëve të kuq në Kamboxhia për të kuptuar sa çnjerëzor është komunizmi e pse duhet dënuar. Shqiptarët e ish-Jugosllavisë kanë qenë vetë viktima të mohimit të të drejtave të njeriut e duhet që të dënojnë regjimet komuniste si format më ekstreme të zhveshjes së njeriut nga të drejtat më themelore.

Së dyti, figura e Enver Hoxhës dhe regjimit komunist duhet shqyrtuar nga shqiptarët e ish-Jugosllavisë edhe në prizmin e solidaritetit mbarëkombëtar dhe keqardhje për vuajtjet ekstreme të shtetasve shqiptarë të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Instituti Studimit të Krimeve të Komunizmit në raportin e tij ka nxjerrë se gjatë regjimit janë vrarë 6 027 vetë, janë burgosur dhe dënuar për arsye politike 34 135 vetë dhe janë internuar në kampe përqendrimi 59 009 persona. Torturat dhe kushtet e rënda gjatë qëndrimit në burgjet e komunizmit iu kanë shkaktuar vdekjen 984 qytetarëve dhe kanë shkaktuar humbjen e aftësive mendore gjatë qëndrimit në burgjet e komunizmit 308 personave. Në raport thuhet se këtu nuk janë llogaritur me mijëra qytetarë që janë vrarë nga viti 1944-1955, pasi për ta nuk ka gjurmë në arkiva. Pra, të qenit shqiptar kërkon jo vetëm solidarizimin e shqiptarëve të Shqipërisë me ata të Kosovës gjatë robërisë, por edhe anasjelltas, dhembshurinë për vuajtjet e shkaktuar nga regjimi më i egër komunist në Evropë.



Një ndër provat kryesore të rolit negativ që Enver Hoxha ka pasur për çështjen kombëtare është padyshim mënyra se si ai e nëpërkëmbi çështjen çame. Në shkurt të vitit 1943 u krijua çeta "Çamëria" që pak më vonë u shndërrua në batalionin "Çamëria" me mbi 2000 mijë partizanë ku shumica dërrmuese ishin çamë. Ky formacion ndërmori disa beteja heroike dhe ishte dëshmia edhe më e mirë se shqiptarët çamë luftuan kundër fashistëve. Mirëpo në qershor të vitit 1944, Enver Hoxha, duke e konsideruar çështjen çame tekstualisht "si patate të nxehtë që do kërcënonte marrëdhënien me Greqinë" vendosi që t'ia ndryshonte emrin në batalionin Thanas Ziko. Duke i vënë emrin e një minoritari grek dhe hequr emrin Çamëria, Hoxha iu dha sinjalet e para grekëve se do e injoronte problemin çam. Po ashtu në vend që të dërgonte Ushtrinë Antifashiste Nacional-Çlirimtare masakrat ndaj shqiptarëve civilë të pambrojtur të Çamërisë, e dërgoi në Jugosllavi çka tregon që kjo ushtri nuk e ka pas merituar emrin "nacional çlirimtare".

Në fund të vitit 1945 deri në 1945, dy divizione partizane V dhe VI me rreth 10 000 trupa nën komandën e Gjin Markut dhe Rrahman Parllakut vazhduan luftën në Jugosllavi deri në Vishegrad afër Sarajevës mbi 100 kilometra larg trojeve shqiptare, në ndjekje të forcave gjermane që tërhiqeshin drejt Berlinit. Më shumë se 700 partizanë ranë në luftimet kundër gjermanëve në Jugosllavi në të njëjtën kohë kur Zerva në krye të formacioneve kolaboracioniste të nazistëve masakronin me mijëra civilë çamë të pambrojtur vetëm pak kilometra në jug të kufirit të Shqipërisë. Po ashtu pas mbarimit të Luftës së II Botërore, në vend që të merrej me zgjidhjen e kthimit të refugjatëve çam në vendlindje, Hoxha futi hundët në politikën e brendshme të Greqisë duke mbajtur krahun e EAM-ELLAS-it në luftën civile të Greqisë dhe për rrjedhojë duke dëmtuar simpatinë ndërkombëtare për shqiptarët e dëbuar nga Çamëria.

Por diktatori nuk u mjaftua me këtë gjë, në vitin 1953 Enver Hoxha konfiskoi dokumentet greke hoqi në mënyrë të dhunshme shtetësinë greke të refugjatëve çamë që ishin në Shqipëri duke ua bërë edhe më të vështirë kthimin ligjor të tyre dhe pretendimet legjitime që ata kishin për kthimin e pronësisë. Në të njëjtën linjë të qëndrimeve të tija antiçame që synonin të akomodonin e ti jepnin garanci shtetit grek, në vitin 1960 Hoxha iu dha çamëve që ishin në Shqipëri një goditje finale duke ndërmarrë gjyqin e sajuar ndaj grupit të 65 çamëve të drejtuar nga admiral Teme Sejko e cila jo vetëm eliminoi zyrtarët më të lartë e figurat më të shquara çame, por u shoqërua me një persekutim të familjeve të tyre dhe gjithë çamëve në përgjithësi.

E ashtuquajtura Lufta Antifashishte Nacional Çlirimtare (LANÇ) që në zanafillë u dominua jugosllave. Dokumentet e deklasifikuara të shërbimeve sekrete perëndimore tregojnë se disa nga figurat kryesore të luftës antifashiste ishin faktikisht agjentë të Jugosllavisë të cilët u aktivizuan në luftë kundër pushtuesve italianë me kërkesën dhe sponsorizimin e britanikëve, të cilët donin që të hapnin një front të ri në Shqipëri kundër fashizmit. Kështu për shembull Myslim Peza dhe Haxhi Lleshi, të cilët ishin rekrutuar nga shërbimet jugosllave u kthyen në Shqipëri dhe organizuan veprime të armatosura me fondet që vinin nga Londra. Po ashtu janë të panumërta dokumentet që e dëshmojnë katërçipërisht se Partia Komuniste e Shqipërisë u formua më 8 nëntor 1941 nga dy emisarë jugosllavë Dushan Mugosha dhe Miladin Popoviç, të cilët e drejtuan këtë parti deri në fund të luftës.

Faktikisht Partia Komuniste Shqiptare ishte vetëm një degë e partisë komuniste jugosllave, deri në vitin 1948 kur Titoja u prish me Stalinin. Vetëm kur Bashkimi Sovjetik e futi Shqipërinë në zonën e vet të influencës, Partia Komuniste Shqiptare u bë e pavarur prej ndikimit jugosllav dhe ndryshoi emrin në Partia e Punës së Shqipërisë.

Por mungesën e nacionalizmit dhe kontrollin nga jugosllavët e dëshmon akoma më mirë prishja e marrëveshjes që doli nga konferenca e Mukjes. Kjo konferencë synonte të bashkonte të gjithë shqiptarët në rezistencën ndaj fashistëve dhe u mbajt në 1-3 gusht 1943 me pjesëmarrjen e 12 përfaqësuesve të Frontit Nacionalçlirimtar dhe 12 përfaqësuesve të Ballit Kombëtar. Pas shumë diskutimesh dhe lëshimesh të dyanshme, u arrit marrëveshja për luftë të përbashkët dhe të menjëhershme kundër pushtuesit përkrah aleatëve të mëdhenj dhe u krijua edhe Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë si një organ i përbashkët i bashkërendimit të luftës që përbëhej nga 6 përfaqësues nga secila palë. Por pika 2 e proklamatës që doli nga marrëveshja ishte veçanërisht problematike për jugosllavët, sepse thoshte "Pika 2. Luftë për një Shqipëri independente dhe për zbatimin e parimit të njohur universalisht e të garantuar nga Karta e Atlantikut të vetëvendosjes së popujve për një Shqipëri Etnike.". Emisarët jugosllavë Svetozar Vukmanovic-Tempo dhe Miladin Popoviç e bindën Enver Hoxhën që ta mohonte dhe prishte këtë marrëveshje madje Hoxha shkoi edhe më tej duke nisur sulmin ndaj Ballit Kombëtar duke nisur një luftë civile paralel me atë antifashiste. Po ashtu Enver Hoxha nuk e përshëndeti aspak Konferencën e Bujanit që u mbajt në 31 dhjetor 1943-2 janar 1944, në Bujan të Tropojës, u mbajt ajo që është quajtur Konferenca e Bujanit, e cila në rezolutën e saj shprehu haptazi vullnetin për bashkim kombëtar nëpërmjet luftës kundër fashizmit. Madje organi i partisë komuniste shqiptare "Zërit të popullit" në atë kohë kur raportonte për Konferencën e Bujanit e kishte censuruar plotësisht fjalinë lapidare të rezolutës së kësaj konference që thoshte se "populli i Kosovës e i Rrafshit të Dukagjinit si gjithmonë dhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipnin".

Mungesën e dimensionit nacionalist të Enver Hoxhës e tregon edhe implikimi i ushtrisë partizane shqiptare në çarmatosjen e rezistencës nacionaliste kosovare si dhe në transportimin e partizanëve kosovarë nëpërmjet territorit të Shqipërisë drejt masakrës së Tivarit. Partizanët e Enver Hoxhës e ndihmuan projektin e zhdukjes së kosovarëve në Tivar duke dorëzuar tek jugosllavët të gjithë të arratisurit shqiptarë nga trevat e tyre, por edhe gjithë vullnetarët shqiptarë të Kosovës që u bashkoheshin batalioneve të UNÇL e mandej jugosllavët i çuan këta në thertoren e Tivarit. Tradhtia e Enver Hoxhës ndaj Kosovës u pa edhe në Konferencën e Paqes në Paris, në gusht 1946, kur u përmend çështja e Kosovës, Enver Hoxha do të deklaronte haptazi se: "Ne nuk kemi pretendime ndaj aleatit tonë, Jugosllavisë". Faktikisht jo vetëm që Enver Hoxha nuk kërkonte bashkimin kombëtar me trojet e ngelura në Jugosllavi, por qe i gatshëm edhe për ta bërë Shqipërinë republikën e 7-të të federatës së sllavëve të jugut. Për këtë qëllim u bë bashkimi monetar dhe doganor, u ndryshua dita e çlirimit nga 28 nëntor në 29 nëntor për ta përshtatur me çlirimin e Jugosllavisë dhe ushtarët tanë u integruan në strukturat e ushtrisë jugosllave me të njëjtën uniformë e u ndërmorën veprime të tjera në këtë drejtim. Pavarësia e Shqipërisë shpëtoi vetëm prej prishjes që Stalini pati me Titon në vitin 1948 dhe që si pasojë e kësaj thyerje Bashkimi Sovjetik e nxori Shqipërinë nga kthetrat e Jugosllavisë dhe e futi në sferën e vet të influencës.

Por për të kuptuar akoma më qartë mungesën e dimensionit patriotik të enverizmit, mjafton të shikohet heshtja e regjimit komunist ndaj krimeve e padrejtësive që iu bëheshin shqiptarëve të ish-Jugosllavisë edhe gjatë viteve në vijim kur nuk Shqipëria nuk ishte më nën ndikimin jugosllav, por kishte prapa Bashkimin Sovjetik.

Shqipëria jo vetëm që nuk i ka denoncuar në arenën ndërkombëtare por as nuk i ka përmendur në shtypin vendas apo në tekste mësimore të kohës. Shqipëria komuniste mbështeste pafund protesta, denoncime apo rezoluta në OKB që kishin të bënin me solidaritet komunist antikapitalist si ato kundër Izraelit pro Palestinës, kundër SHBA e pro viet-kongëve, për regjimet komuniste në Amerikë Latine apo lëvizjet çlirimtare dekolonizuese në Afrikë e gjithfarë nismash ndërkombëtare të këtij lloji, mirëpo nuk bënte të njëjtën gjë për Kosovën. Pra, edhe pse nuk mund të ofronte mbrojtje

*(vijon në faqen 22)*

GAZETA SHQIPTARE

Dje në "Zërin e Amerikës"

# Koha për marrëveshje historike me Serbinë

Nga Hashim Thaçi

*(vijon nga faqja 1)*

… Serbinë, bartë me vete shumë rreziqe, por, sipas tij, "nuk ka rrezik më të madh për ne si Kosovë sesa të vazhdojmë të qëndrojmë kështu në një gjendje pezull si shtet dhe si shoqëri".

Ai i bëri këto komente para shefave të misioneve diplomatike të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, ambasadës amerikane, KFOR-it, OSBE-së dhe EULEX-it.

"Është koha për marrëveshjen e madhe, historike, në mes të dy shteteve. Nuk mund të kthehemi prapa, sepse historia e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është një histori tragjike. Nuk mund të qëndrojmë në vend apo të vendnumërojmë dhe as nuk kemi se çfarë të presim, sepse ngecja dhe pritja në zgjidhjen e raporteve në mes Kosovës dhe Serbisë është pikërisht thirrje për tensione, për destabilizim, për probleme të mëdha, jo vetëm në mes nesh, por edhe në mbarë rajonin". Ai tha se nuk ka kohë për të humbur as për Kosovën e as për Serbinë dhe marrëveshja duhet të arrihet në muajt e ardhshëm. Kosova, tha ai, si shtet, si politikë dhe si shoqëri, është lodhur nga ngecja në procesin e konsolidimit të brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Qoftë për shkak se Serbia ndërhyn në punët e shtetit të Kosovës, qoftë për shkak se Bashkimi Evropian nuk arriti ta krijojë konsensusin për ta njohur shtetin e Kosovës, apo sepse shumëkush ka menduar që me kalimin e kohës, vetvetiu, gjërat në Kosovë dhe rreth Kosovës do të zgjidhen. Ky mendim doli krejtësisht i gabuar, theksoi ai duke shpalosur pikëpamjet e tij për procesin. "Së pari, ne si Kosovë synojmë një marrëveshje të përhershme me Serbinë, jo një tjetër marrëveshje kalimtare që vetëm sa i shtyn gjërat për disa vite. Së dyti, për ne normalizim i plotë i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është njohja formale, reciproke, në mes të shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë",-tha ai duke nënvizuar se përmes kësaj marrëveshjeje do të hapej mundësia që Kosova të bëhet anëtare e OKB-së, OSBE-së, paktit NATO dhe t'i ofrohet perspektiva e anëtarësimit në BE. "Së katërti, njohja reciproke në mes të dy shteteve, do të mund të përcillet edhe me një proces të dakorduar në mes të dy palëve për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Duhet të jem sërish shumë i qartë: Ky proces do të shënonte fundin e konfliktit të gjatë mbi një shekull në mes të Kosovës dhe Serbisë, jo fillimin e një konflikti të ri. Koha e luftërave dhe konflikteve, në mes të Kosovës dhe Serbisë, për bindjen time, ka kaluar. Por, fundi i kësaj epoke do të konstatohet vetëm kur ta bëjmë marrëveshjen e madhe politike në mes nesh dhe Beogradit". Ai tha se një marrëveshje e tillë do të jetë ndihmesë për paqen dhe qëndrueshmërinë e Ballkanit dhe nuk do të ketë kurrfarë pasojash sa i përket karakterit shumetnik të shoqërisë së Kosovës dhe të drejtave të komuniteteve pakicë dhe se institucionet do të jenë garantues të ruajtjes së trashëgimisë religjioze dhe kulturore serbe në Kosovë, në veçanti të asaj që lidhet me pozitën e Kishës Ortodokse Serbe.



"E di që do të jetë shumë vështirë të bëhet marrëveshja. Ka kundërshtarë të saj të rreptë këtu në Kosovë, por edhe në Serbi. E di që i gjithë ky proces bart në vete rreziqe dhe të panjohura të shumta. Por, nuk ka rrezik më të madh për ne si Kosovë sesa të vazhdojmë të qëndrojmë kështu në një gjendje pezull si shtet dhe si shoqëri", theksoi ai.

Presidenti Thaçi dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, një javë më parë kërkuan mbështetje për një marrëveshje që do të mund të përfshinte edhe ndryshimin e kufijve.

Por, as njëri dhe as tjetri nuk kanë dhënë hollësi se si mund të dukej një marrëveshje e tillë dhe çfarë ndryshimesh do të përfshinte. Presidenti serb e ka shpallur politikë të tij ndarjen ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në vija etnike.

Të shtunën ai kritikoi ashpër opozitën serbe që po u kundërvihet ideve për ndarje e shkëmbim territoresh duke theksuar se "ata po gëzohen nga mundësia që Serbia të mos fitojë asgjë" në procesin e bisedimeve me Kosovën".

Presidenti i Kosovës, thotë se korrigjimi i kufijve do të nënkuptonte bashkimin me Kosovën të luginës së Preshevës, një zonë me shumicë shqiptare në jug të Serbisë.

Idetë e tij janë kundërshtuar nga opozita që kërkon seancë të jashtëzakonshme në parlament, por edhe parti në koalicionin aktual qeverisës.

Të dy presidentët pritet të takohen më 7 shtator në Bruksel me ndërmjetësimin e shefes së politikës së jashtme të Bashkimit Evropian Federica Mogherini në kuadër të asaj që quhet periudha përfundimtare e bisedimeve. Zonja Mogherini tha të premten në Vjenë se pret një takim të vështirë në kërkim të një marrëveshjeje ligjore ndërmjet të dyja vendeve, ndërsa theksoi se "do të do të mbështesë çdo zgjidhje që nuk çon në krijimin e shteteve njëetnike".

Një pjesë e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, në radhë të parë Gjermania e Britania e Madhe, kanë kundërshtuar idenë e ndryshimit të kufijve apo shkëmbimit të territoreve.

Serbia që është zotuar se nuk do të njohë pavarësinë e Kosovës, e cila është në vitin e 11-të shtetësisë së saj. Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet tyre është kusht për integrimet evropiane.

---

*(vijon nga faqja 21)*

ushtarake së paku do të ishte natyrshme që në arenën ndërkombëtare Shqipëria të niste rezoluta, të bënte denoncime apo protesta, madje Shqipëria jo vetëm që nuk e ka thirrur ambasadorin jugosllav për sqarime gjatë situatave të vështira për shqiptarët e ish-Jugosllavisë sikurse duhet ta bëj çdo shtet dinjitoz, por e ka mbajtur Jugosllavinë si partnerin e saj kryesor tregtar.

Regjimi enverist qëndroi duarkryq e nuk bëri asnjë përpjekje ndërkombëtare kundër pastrimit etnik që iu bë trojeve shqiptare duke dëbuar popullsinë në Turqi. Marrëveshja turko-jugosllave e vitit 1953 nënshkruar në Split prej Titos dhe ministrit të Jashtëm turk Fuad Kyprili ripërtëriu marrëveshjen e dikurshme të vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Gjatë periudhës 1953-1965 janë dëbuar rreth 450 mijë shqiptarë dhe janë sjellë dhjetëra mijëra kolonë duke përbërë një pastrim etnik të heshtur masiv. Po ashtu nuk iu dëgjua aspak zëri Shqipërisë kundër masave represive e terrorizuese që shoqëruan fushatën e kërkimit të armëve në dimrin e viteve 1955-56. Po ashtu Tirana qëndroi indiferente edhe ndaj masave ndëshkuese që erdhën pas demonstratave të vitit 1968. E vërteta është se Enveri harxhonte dhjetëra miliona euro për të financuar parti komuniste anembanë botës dhe stërviste në territorin e saj për luftë guerile dhjetëra grupe ushtarake që vinin nga Zaire, Ekuadori, Peruja, Cejloni, Kili, Indonezia e Haiti e shumë vende të tjera mirëpo nuk ka bërë të njëjtën gjë për Kosovën.

Është qesharake të mendosh që diktatori ka pasur ndër mend të sulmojë e çlirojë Kosovën kur dihet që investimi më i madh ushtarak në kohën e tij ka qenë mbushja e vendit me bunkerë të cilët nuk lëvizin, nuk janë ofensivë e shërbejnë vetëm për mbrojtje. Por për "dashamirësinë" e diktatorit për Kosovën mund të "dëshmojnë" më së miri kosovarët që u arratisën nga Jugosllavia me shpresë se do të gjenin strehë në Shqipëri. Mbi 1200 kosovarë u dergjën nëpër burgjet e regjimit kurse mbi 4500 syresh u katandisën në internim në zonat më të humbura të Shqipërisë.

Një tjetër dëm i madh i shkaktuar nga Enveri ka qenë padyshim vendimi i tij për të izoluar tërësish Shqipërinë nga vendet fqinje e për rrjedhojë nga gjysma e kombit e ngelur jashtë. Braktisja e Tiranës dhe pamundësia e komunikimit me shtetin amë mund të konsiderohet padyshim si një nder faktorët kryesorë që çuan në asimilimin e shumë shqiptarëve në trojet tona etnike. Gjatë dekadave të izolimit të Shqipërisë janë asimiluar shqiptarët në Tivar, Plavë e Guci të Malit të Zi si dhe janë boshnjakëzuar në Turin dhe Pazar të Ri të Sanxhakut në Serbi. Po ashtu kanë humbur identitetin kombëtar shqiptarët ortodoksë të Maqedonisë e Greqisë. Po qe se Shqipëria komuniste do t'i kishte mbajtur kufijtë relativisht hapur si ta zëmë Hungaria apo Bullgaria, komunikimi ndër-kufitar nuk do të kishim asimilimin masiv që ka ndodhur mes shqiptarëve të ngelur jashtë shtetit dhe shqipja nuk do të ishte rrudhur në përmasat e sotshme.

Me pak fjalë duhet kuptuar njëherë e mirë, për arsyet e sipërpërmendura, por edhe për shumë arsye të tjera se regjimi komunist i Enver Hoxhës ishte një ndër fatkeqësitë më të mëdha që i kanë ndodhur kombit tonë dhe se Hoxha ishte një narcizist që të vetmen gjë të shtrenjtë kishte mbajtjen me çdo kusht të pushtetit personal. Pra, jo vetëm që nuk ka qenë Hoxha patriot, por ka qenë madje shumë i dëmshëm. Për hir të pushtetit personal ky diktator sadist eliminoi shokët e tij më të afërm dhe ishte i gatshëm të shiste kauzën kombëtare sa herë që ia lypte nevoja. Nga ana tjetër, duhet kuptuar që Kosova dhe trojet e tjera etnike kanë pasur një kosto të jashtëzakonshme oportune prej regjimit enverist dhe se rezistenca e lufta për liri e pavarësi në ish-Jugosllavi nuk ka ardhur prej Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, por e ka pasur burimin vendor te patriotizmi e krenaria kombëtare e shqiptarëve të atyshëm. E ka burimin te një atdhedashuri autentike që ngeli e pashuar pavarësisht një shekull robërie.

---

## HOROSKOPI

### DASHI
Gjëja e fundit që dëshironi sot është një ditë stresi dhe plot dilema. Përpiquni ta jetoni këtë ditë në maksimum dhe të shpenzoni shumë në argëtim. Mos e privoni veten nga kënaqësitë e jetës.

### DEMI
Bëni një shëtitje të gjatë për hir të shëndetit tuaj. Kontrolloni shpenzimet tuaja dhe përpiquni të mos jeni tepër bujar më shumë sesa duhet. Stili i jetesës tuaj ekstravagante mund të shkaktojë tensione në familje.

### BINJAKET
Një udhëtim i papritur mund të jetë i mundimshëm, i cili do t'ju bëjë të mërzitur. Dikush me të cilin jetoni do të mërzitet nëse e keni shpërfillur së fundmi. Armiqtë e fshehtë do të jenë të etur për të përhapur thashetheme rreth jush.

### GAFORJA
Një ribashkim me një mik të vjetër do të ndriçojë gjendjen tuaj shpirtërore. Shpenzimet e papritura mund të shkaktojnë presion financiar. Temperamenti juaj mund t'ju shtyjë në një situatë problematike sot në punë.

### LUANI
Sot është një ditë e mirë për të ndjekur interesin tuaj shpirtëror. Shpenzimet rriten, por rritja e të ardhurave, gjithashtu, është e mirë. Është koha e duhur për sukses dhe lumturi falë përpjekjeve tuaja dhe mbështetjes së dhënë nga anëtarët e familjes.

### VIRGJERESHA
Ditë e mirë për rekreacion dhe argëtim. Nëse merreni me biznes tregoni më shumë vëmendje ndaj shpenzimeve të panevojshme. Do të kaloni një pasdite të këndshme me partnerin tuaj.

### PESHORJA
Disa probleme të fjetura do të shfaqen duke sjellë presion mendor dhe stres. Tendenca juaj për t'i lënë gjërat pas dore do të sjellë zhgënjim. Megjithatë kjo periudhë kalimtare do t'i lërë vendin kënaqësisë.

### AKREPI
Të gjitha investimet duhet të bëhen me kujdes të madh. Nuk favorizoheni në këto momente për të ndërmarrë aventura të rrezikshme veçanërisht kur këtu përfshihen edhe paratë.

### SHIGJETARI
Hapat e guximshëm dhe vendimet kurajoze do të sillnin shpërblime të favorshme. Sot është një nga ato ditë kur gjërat në dashuri nuk do të lëvizin ashtu siç dëshiron.

### BRICJAPI
Shmangni argumentet dhe konfrontimet e panevojshme me të tjerët. Nuk është një ditë shumë e mirë për çështjet e dashurisë. Me pak mirëkuptim dhe tolerancë dita do të kalojë pa probleme.

### UJORI
Kujdesuni për mirëqenien tuaj përndryshe gjërat mund të marrin një kthesë për keq. Çështjet në pritje bëhen më të zymta dhe shpenzimet më të mëdha. Për më shumë paqe mendore, merruni me sport.

### PESHQIT
Pasiguria në lidhje me financat do të krijojë tension në mendjen tuaj. Shmangni një hap të nxituar në dashuri. Nëse një punë nuk ju sjellë kënaqësi shpirtërore, hiqni dorë prej saj tani që nuk jeni shumë vonë.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Niven që qe aktor.
5. Little... kryeqyteti i Arkansas.
7. Janë tek në lakër.
10. Nuk ka akoma një bebe.
11. Kufizojnë katete.
12. Penn aktor.
13. Hector që shkroi Pa familje.
15. Thahen me bonifikime.
18. Mbyllin takimin.
19. Ndërmarrje Industriale Mat.
21. Mbyllen me epilog.
23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
25. Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
27. Njëlloj për latinët.
30. Eshtë vend si Katari.
31. Pupi regjisor.
32. Janë strehat e çobanëve.
33. Eshtë centrali si Chernobyl.
35. Fillojnë një argument.
36. Të parat në stadium
37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërore.
42. Thirrej edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshtë syzë... në komo.

VERTIKALI
1. Hyskja aktor.
2. Kush e thotë lutet.
3. Një tis mjegulle.
4. Maiden që këndojnë.
5. Gjysmë rekord.
6. Antonio skulptor i famshëm.
7. David regjisor.
8. Janë brinjë në skuadër.
9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.
16. Quheshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitara e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si gjoja.
28. Pak daktilografi
29. Eshtë si divan.
31. Një pjesv e amerikanëve.
32. Bernhardt që qe aktore.
34. Eshtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak marramendëse.
43. Eshtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. E bardhë ajo Moby Dick.
5. Fillojnë amplifikimin.
7. Eshtë vit që parashikohet.
10. Mbyllin pamjen.
11. U printe jeniçerëve.
13. Thurman aktore.
14. Një reaksion në provëz.
16. Një sport me brez të zi.
19. Në fund të fundit.
20. Janë në gjyq.
23. I është hequr të dënuarit.
24. Eshtë shahu i fundit
25. Janë fletë trëndafili.
27. Kufizojë një metër.
28. Tregojnë pallate në miniaturë.
29. Një fjalë pa shkak.
30. Janë përllogaritje.
32. Mbyllin një dritare.
33. Të parat në muzg.
34. Me të nxjerrin një letër.
35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balerinë.
39. Inicialet e Reitman regjisor.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Diftong në dietë.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.

VERTIKAL

1. Ishte titulli i Hiro Hitos.
2. Ekberg aktore.
3. Eshtë skuadra.
4. Dy asa.
5. Binjaket në klasa.
6. Qe duhet sajdisur.
7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përrallat e vëllezërve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshtë medalja e të parit.
21. I dhimbset frikacakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshtë llahtar.
28. Janë inate të akumuluara
30. Eshtë vëlla i gruas.
31. Një tip për të këcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akilin.
43. Kodi i celularit.
45. Mbledh baskët separatistë
47. Njëështrë edhe Egjeu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 5 | 8 | | 7 | | | 3 | |
| | | | 5 | | | 4 | | 9 |
| | | | 2 | | 4 | | | 8 |
| | | | | | 8 | 7 | 2 | |
| 7 | | | | | | | | |
| 9 | | | | | 3 | | | |
| | 4 | 2 | | | | | 5 | |
| 1 | | 6 | | | 9 | | | 4 |
| 3 | | 5 | 8 | | | | 1 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 2 | 7 | 8 | 3 | 4 | 1 | 9 | 5 |
| 3 | 1 | 9 | 5 | 6 | 7 | 4 | 2 | 8 |
| 8 | 4 | 5 | 9 | 1 | 2 | 6 | 3 | 7 |
| 1 | 5 | 6 | 2 | 7 | 8 | 3 | 4 | 9 |
| 4 | 7 | 3 | 1 | 5 | 9 | 8 | 6 | 2 |
| 2 | 9 | 8 | 6 | 4 | 3 | 5 | 7 | 1 |
| 9 | 3 | 2 | 4 | 8 | 5 | 7 | 1 | 6 |
| 5 | 6 | 4 | 7 | 2 | 1 | 9 | 8 | 3 |
| 7 | 8 | 1 | 3 | 9 | 6 | 2 | 5 | 4 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

- Njerëzit duhen kur nuk njihen.
- Për të fituar para duhet talent, por për të shpenzuar paratë duhet kulturë.
- Më shumë e dua njeriun e paarsimuar por të çiltër, se sa të arsimuar dhe i poshtër.
- Që të dukesh idiot në sytë e budallait është një kënaqësi estetike.
- Roli i vërtetë i njeriut është të jetojë, e jo të ekzistojë.
- Ata që lexojnë kanë botën, dhe ata që shikojnë TV, e humbasin.

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| R | O | M | A | N | C | I | E | R | E | T | ■ | C |
| I | R | O | N | ■ | L | ■ | ■ | ■ | T | R | U | P |
| T | ■ | R | ■ | T | A | R | T | A | R | E | T | ■ |
| ■ | K | A | M | E | R | I | E | R | E | T | ■ | U |
| D | E | L | I | R | A | N | T | E | T | ■ | P | R |
| C | ■ | ■ | T | A | B | O | R | ■ | A | T | A | ■ |
| ■ | K | R | I | P | E | ■ | A | ■ | ■ | O | L | E |
| S | L | O | ■ | I | L | P | ■ | R | A | U | L | ■ |
| T | A | N | T | A | L | I | ■ | U | R | R | A | ■ |
| U | S | ■ | R | ■ | E | K | I | P | I | ■ | T | E |
| F | A | T | A | L | ■ | A | L | I | E | N | E | T |
| E | T | A | P | A | T | ■ | K | A | T | E | T | I |

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | A | T | ■ | M | L | ■ | T | R | A | J | T | A | T |
| P | L | ■ | K | A | ■ | P | ■ | A | L | I | E | N | E |
| R | E | K | O | R | D | E | T | ■ | P | M | ■ | T | R |
| I | ■ | A | N | S | A | M | B | L | I | ■ | H | E | M |
| M | A | R | T | I | N | E | D | E | N | ■ | I | N | E |
| O | H | A | R | A | ■ | T | ■ | T | I | T | R | A | T |
| ■ | ■ | B | A | N | A | ■ | P | I | S | H | E | ■ | I |
| E | P | I | T | E | T | E | T | ■ | T | E | S | T | ■ |
| M | I | N | A | T | ■ | N | A | I | ■ | ■ | I | M | A |
| I | K | A | ■ | ■ | A | K | ■ | R | I | M | A | ■ | R |
| L | A | ■ | P | A | R | A | R | O | J | A | ■ | ■ | T |
| E | T | I | K | A | ■ | S | E | N | A | T | O | R | I |

FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | A | A | S | ■ | L | U | L | I | ■ | M | A | T | A |
| A | R | R | A | S | ■ | B | A | R | N | U | M | ■ | R |
| L | A | T | ■ | A | B | ■ | R | O | A | ■ | E | F | I |
| L | ■ | ■ | E | L | E | M | E | N | T | A | R | E | ■ |
| A | N | E | T | A | R | E | S | I | A | ■ | I | N | I |
| M | I | N | I | M | A | L | ■ | A | L | E | K | O | ■ |
| I | K | ■ | L | I | T | A | R | ■ | ■ | T | E | M | A |
| ■ | E | S | E | N | I | N | ■ | E | R | I | ■ | E | R |
| P | ■ | A | N | A | ■ | I | ■ | M | E | K | ■ | N | I |
| E | T | N | I | ■ | ■ | E | M | I | N | E | M | ■ | A |
| L | O | T | ■ | A | S | ■ | D | R | I | T | A | T | ■ |
| A | L | A | I | N | ■ | E | M | I | S | A | R | E | T |

Argëtim filozofik



## Thënie të mençura

- Sa më shumë i njoh njerëzit, aq më tepër i dua kafshët.
- Njerëzit janë më të gatshëm për të ta kthyer të keqen se sa të mirën që u bëre, sepse mirënjohja është barrë dhe hakmarrja është kënaqësi.
- Sepse thjesht nuk më intereson, nuk do të thotë se nuk e kuptoj.
- Njerëzit qajnë kur lexojnë fantazitë e poetëve, por vuajtjen e vërtetë të njerëzve e ndjekin me indiferencë.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al